



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 prill 2022
Nr. ref.:AGJ 1977/22

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KO145/21

Parashtrues

Komuna e Kamenicës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Arsimit,
Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/24, të 23 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Kamenicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), dhe është dorëzuar nga kryetari i mëhershëm i kësaj komune z. Qëndron Kastrati.
2. Në zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, respektivisht pas zhvillimit të raundit të dytë me datë 14 nëntor 2021, Kryetar i Komunës së Kamenicës u zgjodh z. Kadri Rahimaj.

Akti i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/24, të 23 prillit 2021 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet shkelja e nenit 12 [Pushteti Lokal], nenit 123 [Parimet e Përgjithshme], nenit 124 [Organizimi dhe Funkcioni i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 2 (Baza Kushtetuese dhe Ligjore e Vetëqeverisjes Lokale) dhe nenin 4 (Fushëveprimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon caktimin e masës së përkohshme për shkak të cenimit të përgjegjësisë komunale dhe për shkak të ndikimit tek nxënësit, duke theksuar se (i) konsideron se kërkesa e tij është *prima facie* e bazuar; (ii) ka ofruar prova të mjaftueshme që do shkaktohet dëm i pa-riparueshëm; dhe (iii) caktimi i masës së përkohshme është me interes publik.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 27 (Masat e përkohshme), 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 56 (Kërkesa për masë të përkohshme) e Rregullin 73 (Kërkesa në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 12 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përmes kryetarit z. Qëndron Kastrati.
8. Më 13 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci.
9. Më 16 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzoi në Gjykatë, Memorandumin të lidhur mes tij dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme: MASHTI) të 25 shkurtit 2020. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri), MASHTI-në, dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL), për regjistrimin e kërkesës dhe duke kërkuar nga ata që komentet t'i dorëzojnë deri më 31 gusht 2021.
10. Më 20 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentin e kërkuar nga Gjykata.
11. Më 31 gusht 2021, MASHTI-i dhe MAPL respektivisht, dorëzuan komentet e tyre në Gjykatë.
12. Më 2 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për pranimin e komenteve nga MASHTI dhe MAPL dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë përgjigje ndaj komenteve, nëse ka, deri më 10 shtator 2021.
13. Më 10 shtator 2021, Gjykata pranoi komentet shtesë nga parashtruesi i kërkesës.
14. Më 20 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë.
15. Më 5 janar 2022, Kryetari i Komunës së Kamenicës z. Kadri Rahimaj, i përfaqësuar nga z. Alban Hashani nga Kamenica, dorëzon parashtresë për tërheqjen e kërkesës KO145/21 në Gjykatë, duke theksuar se Komuna e Kamenicës nuk ka asnjë interes juridik për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
16. Më 18 janar 2022, Gjykata kërkoi nga Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj, të bashkëngjisë autorizimin se po e përfaqëson atë z. Alban Hashani, me rastin e paraqitjes së kërkesës për tërheqje.
17. Më 21 janar 2022, Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj bashkëngjiti autorizimin për z. Alban Hashani.
18. Më 2 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë.

19. Më 10 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri (i) vendosi që të refuzojë kërkesën për tërheqje të kërkesës; dhe (ii) i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe shqyrtimin e saj në merita.
20. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi se Vendimi nr.01B/24, i 23 prillit 2021 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafin 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

21. Sipas shkresave të lëndës, Komuna e Kamenicës [parashtruesi i kërkesës] është përballur me sfida në fushën e arsimit. Kjo kishte rezultuar nga rënia e numrit të nxënësve në Komunën e Kamenicës, dhe faktit që në disa shkolla kishte më pak se pesë (5) nxënës në gjithë shkollën. Poashtu Komuna e Kamenicës përballej edhe me mungesë të infrastrukturës së mirëfilltë të institucioneve arsimore, dhe numër të madh të punësuarve si punëtorë arsimor. Lidhur me këtë të fundit, Komunës së Kamenicës *"iu është m'veshur një barrë e madhe buxhetore"*. Rrjedhimisht, për të përmirësuar arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, parashtruesi i kërkesës kishte ndërmarrë hapa për reformimin e këtij sistemi, përmes ristrukturimit dhe riorganizimit të institucioneve arsimore, përmes nxjerrjes së Vendimeve përkatëse.

Veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës dhe MASHTI

22. Më 30 gusht 2019, parashtruesi kërkesës, merr vendim nr.26937 përmes të cilit:

"1.RIORGANIZOHET arsimi sipas Nivelit 0 dhe 1 të ISCED-it (niveli parashkollor dhe arsimi fillor 1-5), si vijon:

1.1.Në institucionin arsimor "Dëshmoret e Kombit", vijojnë mësimin edhe nxënësit e "ShFMU "Nuhi Berisha", ShFMU "7 Shtatori" dhe ShFMU "Idriz Seferi".

1.2. Në institucionin arsimor "Fan S. Noli", vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Hasan Prishtina".

2. RIORGANIZOHET arsimi Nivelit 2 të ISCED-it (niveli i mesëm ulët shkollimit, 6-9), si vijon:

2.1. Në institucionin arsimor "Dëshmoret e Kombit", vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Nuhi Berisha", ShFMU "7 Shtatori" dhe ShFMU "Idriz Seferi"

2.2. Në institucionin arsimor "Fan S. Noli", vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Hasan Prishtina".

3. *Personeli arsimor, mbështetës, administrativ dhe udhëheqës i shkollave "Dëshmoret e Kombit", "Nuhi Berisha", "7 Shtatori", "Idriz Seferi", "Fan S. Noli" dhe "Hasan Prishtina" do të trajtohen njësoj në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.*
4. *Riorganizimi i institucioneve arsimore sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij Vendimi do të fillojë të zbatohet me fillim të Vitit Shkollor 2019/2020.*
5. *Koha e fillimit të riorganizimit të institucioneve tjera arsimore në Komunën e Kamenicës do të caktohet me vendim të ri.*
6. *Veprimet përgatitore për zbatimin e riorganizimit të institucioneve arsimore në Komunën e Kamenicës, do të ndërmerren nga hyrja në fuqi të këtij Vendimi.*
7. *OBLIGOHET Drejtoria Komunale e Arsimit që me qëllim të njësimt të institucioneve arsimore të fuzionuara, të iniciojë procedurat për themelimin e Institucioneve Arsimore sipas UA/MAShT 08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsimore.*
8. *URDHËROHEN Institucionet arsimore të cilave u drejtohet ky Vendim që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për riorganizimin e institucioneve sipas këtij Vendimi, në konsultim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Kamenicës.*
9. *Komuna e Kamenicës në cilësi të njësisë themelore administrative, mbi bazën e kompetencave ligjore mbi arsimin publik, duke u mbështetur në nevojat faktike dhe organizative, duke u mbështetur në nevojën për ofrimin e arsimit cilësor në Komunën e Kamenicës, duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 4 paragrafi 4.1 të Ligjit 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nenit 14, paragrafi 9 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 3, paragrafi 1.2. të UA 24/2016 (MAShT) për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe UA (MAShT) 22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës, vendosi sipas këtij Vendimi.*
10. *Caktimi i të punësuarve në institucionet e arsimit të cilat përfshihen në procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit sipas këtij Vendimi, do të trajtohen në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive në Arsim, e lidhur në vitin 2017 në mes të SBASHK-ut dhe MAShT-it, përkitazi me tepricën teknologjike.*
11. *Në rast të lidhjes së kontratës Kolektive Lokale dispozita nga paragrafi 9 i këtij Vendimi do të zbatohet përshtatshëmrisht me dispozitat e veçanta të kontratës Kolektive të lidhur në nivel të ndërmarrjes (Komunës së Kamenicës).*

12. Vendimit i bashkëngjitet dokumenti shpjegues për riorganizimin e shkollave.

13. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.”

23. Më 10 janar 2020, parashtruesi i kërkesës nxjerr vendimin nr. 02/805, përmes të cilit:

“1.RIORGANIZOHET arsimit sipas Nivelit 0 dhe 1 të ISCED-it (niveli parashkollor dhe arsimit fillor 1-5), si vijon:

1.1.Në institucionin arsimor "Abdullah Krashnica -Presheva", vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Rexhep Mala".

2. RIORGANIZOHET arsimit i Nivelit 2 të ISCED-it (niveli i mesëm ulët shkollimit, 6-9), si vijon:

2.1. Në institucionin arsimor "Rexhep Mala", vijojnë mësimin edhe nxënësit e "Abdullah Krashnica - Presheva".

3. Personeli arsimor, mbështetës, administrativ dhe udhëheqës i shkollave do të trajtohen njësoj në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

4. Riorganizimi i institucioneve arsimore sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij Vendimi do të fillojë të zbatohet me fillim të Periudhës së Dytë të Vitit Shkollor 2019/2020.

5. Koha e fillimit të riorganizimit të institucioneve tjera arsimore në Komunën e Kamenicës do të caktohet me vendim të ri.

6. Veprimet përgatitore për zbatimin e riorganizimit të institucioneve arsimore në Komunën e Kamenicës, do të ndërmerren nga hyrja në fuqi të këtij Vendimi.

7. OBLIGOHET Drejtoria Komunale e Arsimit, të iniciojë procedurat për themelimin e Institucioneve Arsimore të ndara sipas cikleve, sipas UA/MAShT 08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsimore.

8. URDHEROHEN Institucionet arsimore të cilave u drejtohet ky Vendim që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për riorganizimin e institucioneve sipas këtij Vendimi, në konsultim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Kamenicës.

9. Komuna e Kamenicës në cilësi të njësisë themelore administrative, mbi bazën e kompetencave ligjore mbi arsimin publik, duke u mbështetur në nevojat faktike dhe organizative, duke u mbështetur në nevojën për ofrimin e arsimit cilësor në Komunën e Kamenicës, duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 4 paragrafi 4.1 të Ligjit 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës

së Kosovës, Nenit 14, paragrafi 9 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 3, paragrafi 1.2. të UA 24/2016 (MASHT) për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe UA (MASHT) 22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës-Nxënës, vendosi sipas këtij Vendimi.

10. Caktimi i të punësuarve në institucionet e arsimit të cilat përfshihen në procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit sipas këtij Vendimi do të trajtohen në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive në Arsim, e lidhur në vitin 2017 në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it, përkitazi me tepricën teknologjike.

11. Me hyrjen në fuqi të Kontratës Kolektive Lokale dispozita nga paragrafi 10 i këtij Vendimi do të zbatohet përshtatshëmrisht me dispozitat e veçanta të Kontratës Kolektive të lidhur në nivel të ndërmarrjes (Komunës së Kamenicës).

12. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.”

24. Më 10 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës nxjerr vendim të ri me nr.02/19870 përmes të cilit:

1. RIORGANIZOHET arsimi sipas Nivelit 0, 1 dhe 2 të ISCED-it (niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9), si vijon:

1.1. Në institucionin arsimor "Avni Rrustemi" në Karaçevë të Epërme, vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Asllan Thaçi" nga Karaçeva e Epërme.

2. RIORGANIZOHET arsimi sipas Nivelit 0, 1 dhe 2 të ISCED-it (niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9), si vijon:

2.1. Në institucionin arsimor "Rexhep Mala" në Topanicë, vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU "Xhelal Sopi" nga Petroci.

3. RIORGANIZOHET arsimi i Nivelit 0, 1 dhe 2 të ISCED-it (niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9), si vijon:

3.1. Në institucionin arsimor "Skënderbeu" në Hogosht, vijojnë mësimin edhe nxënësit e paraleleve të ndara në Kopernicë, Lisockë, Dazhnicë dhe paralelet e ndara në Poličkë dhe Velegllavë të ShFMU "Kadri Zeka".

4. RIORGANIZOHET arsimi sipas Nivelit 0, 1 dhe 2 të ISCED-it (niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9), si vijon:

4.1. Në institucionin arsimor "Sadri Misini" në Shipashnicë të Epërme, vijojnë mësimin edhe nxënësit e paraleles së ndarë në Shipashnicë të Poshtme, nxënësit e ShFMU "Kadri Zeka" në Desivojcë dhe paralelet e saj të ndara në Laçiç, Tërstenë dhe Sedllar.

5. *RIORGANIZOHET* arsimi sipas Nivelit 0 dhe 1 të ISCED-it (niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5), si vijon:
- 5.1. Në institucionin arsimor "17 Shkurti" në Muçiverc, vijoje në mësimin edhe nxënësit e paraleleve të ndara në Krenidell dhe Dajkoc.
Personeli arsimor, mbështetës, administrativ dhe udhëheqës i shkollave do të trajtohen njësoj në baze të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.
7. Riorganizimi i institucioneve arsimore sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij Vendimi do të fillojë të zbatohet me fillim të Vitit Shkollor 2020/2021.
8. Veprimet përgatitore për zbatimin e riorganizimit të institucioneve arsimore në Komunën e Kamenicës, do të ndërmerren nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
9. *OBLIGOHET* Drejtoria Komunale e Arsimit që me qëllim të njësimimit të institucioneve arsimore të fuzionuara, të iniciojë procedurat për themelimin e institucioneve Arsimore sipas UA/MAShT 08/2015 për Themelimin e institucioneve Arsimore.
10. *URDHEROHEN* Institucionet arsimore të cilave u drejtohet ky Vendim që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për riorganizimin e institucioneve sipas këtij Vendimi, në konsultim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Kamenicës.
11. Komuna e Kamenicës në cilësi të njësisë themelore administrative, mbi bazën e kompetencave ligjore mbi arsimin publik, duke u mbështetur në nevojat faktike dhe Organizative, duke u mbështetur në nevojën për ofrimin e arsimit cilësor në Komunën e Kamenicës, duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 4 paragrafi 4.1 të Ligjit 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nenit 14, paragrafi 9 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 3, paragrafi 1.2. të UA 24/2016 (MAShT) për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe UA (MAShT) 22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës-Nxënës, vendosi sipas këtij Vendimi.
12. Caktimi i të punësuarve në institucionet e arsimit të cilat përfshihen në procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit sipas këtij Vendimi, do të trajtohen në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive në Arsim, e lidhur në vitin 2017 në mes të SBAShK-ut dhe MAShT-it dhe Kontratës Kolektive të lidhur në nivel të nënndarjes, në mes të SBAShK-ut dhe Komunës së Kamenicës.
13. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.”
25. Më 14 janar 2020, Inspektorati i Arsimit në kuadër të MASHTI-it, realizoi inspektimin në disa shkolla të Komunës së Kamenicës, dhe gjeti se (i) sh.f.m.u. "Idriz Seferi" në Strezovc respekton vendimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) sh.f.m.u. "Nuhi Berisha" në Tuxhevc, respekton vendimin e parashtruesit të

kërkesës; (iii) kurse, sh.f.m.u. "7 Shtatori" në Krilevë dhe sh.f.m.u. "Hasan Prishtina" në Busavatë nuk respektojnë vendimin e parashtruesit të kërkesës. Me këtë rast, inspektorët e arsimit vlerësuan se (i) vendimin nr.02/26937 të 30 gushtit 2019 nga parashtruesi i kërkesës për sh.f.m.u. "Hasan Prishtina" në Busavatë nxënësit duhet ndjekur mësimin në të njëjtën shkollë duke marrë parasysh numrin e 107 nxënësve si dhe ndërtimin e objektit të ri shkollorë që është në përfundim e sipër; (ii) sh.f.m.u."7 Shtatori" në Krilevë dhe sh.f.m.u." Idriz Seferi" në Strezovc për shkak të numrit të vogël të nxënësve si dhe distancës gjeografike shkollat janë afër njëra tjetrës, të fuzionohen në një shkollë të përbashkët me nr. të nxënësve në Krilevë 25 nxënës kurse në Strezovc janë 75 nxënës. Rrjedhimisht, Inspektorët e Arsimit rekomandojnë: 1. DKA në Kamenicë të gjejë forma dhe zgjidhje për stabilizimin e gjendjes në këto shkolla; dhe 2. DKA në Kamenicë t'i pajisë këto shkolla me ditarët e klasave dhe me tekste shkollore.

26. Më 25 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dhe MASHTI, nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, përmes të cilit: (i) respektohet Vendimi nr. 26973 i 30 gushtit për riorganizimin e shkollave "Fan Noli", "Dëshmorët e Kombit", "Hasan Prishtina", "7 Shtatori", "Idriz Seferi" dhe "Nuhi Berisha"; (ii) shtyhet për fazën tjetër Vendimi nr.805 i 10 janarit 2020 që përfshinë shkollat "Abdullah Krashnica Presheva" dhe "Rexhep Mala" dhe koha kur do aplikohet ky vendim do përcaktohet nga organi kompetent; (iii) dy palët nënshkruese angazhohen në avancimin e infrastrukturës shkollore, hapjen e dy çerdheve duke ridestinuuar objektet ekzistuese shkollore, dhe investojnë në pjesë përkatëse; (iv) MASHTI do investojë në rindërtimin e shkollës "Fan S. Noli" (v) në bashkëpunim me donatorë, të nisë një studim i përgjithshëm dhe i detajuar lidhur me riorganizimin e shkollave (me numër të pamjaftueshëm nxënësish) në nivel vendi, studim ky që do gjenerojë të dhëna të besueshme të cilat do shërbejnë në vendimmarrje të drejtë të bazuar në dhëna të sakta për gjithë vendin; (vi) rezultatet e këtij studimi në nivel vendi, duke studiuar edhe politikat e Komunës së Kamenicës, të shërbejnë për orientimin e politikave arsimore në nivel nacional sa i përket riorganizimit të rrjetit të shkollave me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies (vii) dy palët nënshkruese në konsultim me komunitetin do angazhohen në rivlerësimin e propozimit për riorganizimin e arsimit në Komunën e Kamenicës; (viii) të dy institucionet pajtohen që do të respektojnë vendimin e organit kompetent për organizimin e arsimit parauniversitar, duke ndihmuar aktivisht në implementimin e tij; (ix) parashtruesi i kërkesës përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit, përgatitë dhe zbaton planin për kompensimin e orëve të humbura; (x) mësimi në të gjitha shkollat vazhdon normalisht.
27. Më 22 gusht 2020, MAPL lëshon një Opinion ligjor për MASHTI-in "*në lidhje me kompetencat vetanake të Komunave si dhe organeve komunale në lidhje me arsimin para universitar, gjegjësisht riorganizimin e shkollave filllore dhe të mesme-Rasti i Kamenicës*". Në këtë Opinion ligjor, konkludohet që (i) Në bazë të nenit 17, paragrafi 1 nënparagrafi (h) i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Vetëqeverisje Lokale), Komunitet kanë të drejtë në vendimmarrje sa i përket arsimit publik fillor dhe të mesëm dhe në kuadër të kësaj kompetence mund të riorganizojnë arsimin publik fillor dhe të mesëm; (ii) Në bazë

të nenit 13, dhe 57, paragrafi (c) i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i Komunës ka të drejtë si organ ekzekutiv të nxjerrë vendime ligjore në fushën e arsimit publik fillor dhe të mesëm, meqë kjo kompetencë nuk i takon shprehimisht me ligj Kuvendit të Komunës.

28. Me 26 gusht 2020, Inspektorati i Arsimit mbajti procesverbal përmes të cilit u bë verifikimi i dëftesave të nivelit të dytë në sh.f.m.u “Hasan Prishtina” në Busavatë, me ç’rast janë gjetur se (i) dëftesat e nivelit të dytë (VI-IX) për disa nga nxënësit të sh.f.m.u “Hasan Prishtina” në Busavatë, janë lëshuar nga drejtori jo-legjitim dhe (ii) në ish sh.f.m.u “Hasan Prishtina” në Busavatë, në tri lëndë ishin të angazhuar nga banorët e fshatit dhe të njëjtit nuk ishin në sistemin e pagave në DKA; (iii) nxënësit e sh.f.m.u “Hasan Prishtina” në Busavatë, sipas vendimit 02/26937 të 30 gushtit 2019, të parashtruesit të kërkesës, duhej të sistemoheshin në sh.f.m.u “Fan Noli” në Kamenicë. Rrjedhimisht, Inspektorët e Arsimit, Rekomandojnë që të 1. anulohen dëftesat për 6 (gjashtë) nxënësit përkatës; 2. DKA të gjejë formën e organizimit të notimit në lëndët përkatëse; 3. DKA të veprojë sipas legjislacionit në fuqi për lëshimin e dëftesave të nivelit të dytë; 4. Organet kompetente të iniciojnë procedurën ndaj drejtorit jo-legjitim.
29. Më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Kosovës.
30. Më 29 mars 2021, Inspektorati i Arsimit dërgoi informatë në MASHTI, duke i raportuar për vijueshmërinë e nxënësve në shkolla, bazuar në Vendimet e parashtruesit të kërkesës.
31. Më 8 prill 2021, MASHTI nxjerr Vendimin 01B/14 për formimin e komisionit *ad-hoc* për shqyrtimin e problemit të krijuar me mos vijimin e mësimi nga një numër i nxënësve në Komunën e Kamenicës, gjithsejtë 441 nxënës. Detyra e këtij komisioni është (i) të analizohet informacioni ekzistues për problemin e krijuar në Komunën e Kamenicës; (ii) sipas nevojës të mbledhë informata shtesë përmes komunikimit me strukturat e Komunës së Kamenicës, shkollat dhe komunitetet e prekura, përfshirë vizitat në teren; (iii) të përqendrohet /propozojë gjetjen e rrugëdaljeve nga situata ekzistuese duke pasur parasysh interesin e fëmijëve dhe obligimin e institucioneve shtetërore për të siguruar përfundimin e rregullt të viteve shkollore 2019/2020 dhe 2020/2021; (iv) t’i paraqesë MASHTI-it, një raport të punës me rekomandime deri më 13 prill 2021. Anëtarë të këtij komisioni, ishin eksperte të arsimit, zyrtarë të MASHTI dhe zyrtar i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës.
32. Më 14 prill 2021, Komisioni *ad-hoc* përpiloi një Raport, përmes të cilit gjeti se përpjekjet e Komunës, MASHTI dhe komunitetit të prindërve për të gjetur zgjidhje në kthimin e nxënësve në shkollë, përtej kufizimeve ligjore dhe vendimeve për riorganizimin e shkollave, kanë munguar deri më sot dhe ka pasur qasje të fragmentuar, burokratike dhe e orientuar drejt gjykatave e padive ndërmjet palëve të përfshira, duke u injoruar dëmi që po ju shkaktohet fëmijëve të shkollave të

prekura nga riorganizimi. Komisioni vlerësoi se faza e dytë e riorganizimit të shkollave ishte e shpejtuar dhe nuk janë marrë për bazë rrethanat e krijuara nga pandemia, sidomos për tri skenarët e organizimit të mësimin (Skenarët A, B dhe C). Komisioni kishte dhënë komente lidhur me shkollën sh.f.mu. "Hasan Prishtina" në Busavatë, dhe shprehi mendimin se kjo shkollë nuk është dashur të përfshihet në planin e riorganizimit. Për shkak të humbjeve deritanishme mësimore, Komisioni shprehi mendimin që duhet të jetë organizimi i mësimin në shkollë e jo online. Komisioni në fund, dha rekomandime lidhur me veprimet e nevojshme duke i ndarë ato në nivelin politik dhe nivelin teknik. Lidhur me të parën, Komisioni theksoi se (i) MASHTI, duhet të ndërmarë veprime të harmonizuara me Komunën e Kamenicës, duke përfshirë prindërit, që të mundësohet kthimi i menjëhershëm në shkollë i nxënësve; (ii) MASHTI në marrëveshje me Komunën e Kamenicës të themeloi grup pune, ku do analizohet situata në shkollë; (iii) MASHTI të autorizojë Divizionin për Kurrikula që të fillojë përgatitjet për përkrahje të mësimdhënësve të këtyre shkollave; (iv) të sigurohet buxheti i nevojshëm nga MASHTI për Divizionin për Kurrikula, për sigurimin e materialeve shtesë; (v) MASHTI duhet të angazhohet për veprime të menjëhershme me qëllimin e rregullimit ligjor dhe procedural për riorganizimin e rrjetit të shkollave në nivel të Kosovës. Sa i përket aspektit teknik, Komisioni rekomandoi (i) përgatitjen e planit të detajuar për organizimin e mësimin kompensues; (ii) hartimin e një udhëzuesi të thjeshtë dhe praktik për mësimdhënësit lidhur me planifikimin e mësimdhënies; (iii) planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve mbështetëse për arkivat profesionale përmes ligjëratave, orëve mësimore e mentorimit; (iv) planifikimi dhe organizimi i inspektimeve mbështetëse nga Inspektorati i Arsimit me qëllim të sigurimit të të dhënave lidhur me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.

33. Më 23 prill 2021, MASHTI nxjerr Vendimin 01B/24, për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës, me arsyetimin që ky vendim është bazuar në obligimin e MASHTI-it për të garantuar të drejtën për arsim dhe rekomandimet e raportit të komisionit *ad-hoc* të 14 prillit 2021 mbi nevojën e kompensimit të orëve të humbura, dhe raportet e inspektoratit. Përmes Vendimin 01B/24 vendoset që të:

"1. Kompensohen orët e humbura përmes organizimit të mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (1-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX);

- 1.1. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Shipashnicë e Poshtme;*
- 1.2. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Kopernicë;*
- 1.3. Nxënësit e SHFMU "Hasan Prishtina" në Busavatë;*
- 1.4. Nxënësit e SHFMU "Asllan Thaqi" në fshatin Karaçevë e Poshtme;*
- 1.5. Nxënësit e SHFMU "Xhelal Sopi" në fshatin Petrocë.*

2. Themelohet komisioni në kuadër të MASHTI-t për hartimin e përmbajtjes mësimore për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit sipas pikës I të vendimit.

3. Mësimi alternativ i përshpejtuar për nxënësit sipas pikës 1 të këtij vendimi, zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës.

4. Orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit sipas pikës 1 të vendimit, të mos pengohen nga orari i mësimit që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna.

5. Obligohet DKA në Kamenicë të sigurojë kushte optimale dhe furnizimin me materiale mësimore për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor për nxënësit sipas pikës I të vendimit.

6. Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës obligohet që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike në fuqi dhe të këtij vendimi, me qëllim të krijimit të kushteve për funksionimin e rregullt dhe të papenguar të procesit edukativo-arsimor.

7. Procesi mësimor zhvillohet në objektet shkollore me të afërta dhe në pajtim me rekomandimet e MASHTI, MSH dhe IKSHPK-së.

8. Task forca në nivel të shkollës e themeluar sipas vendimit me nr. 01B-1 01 të datës 11.09.2020, sigurojnë që institucionet edukativo-arsimore kane krijuar të gjitha kushtet për rifillimin e procesit mësimor.

9. Mësimi i përshpejtuar plotësues do të fillojë me 4 maj 2021.

10. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.”

34. Më 27 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në MASHTI në lidhje me zbatimin e Vendimit 01B/24, duke theksuar se Komuna merr përsipër zbatimin e vendimit 01B/24, përkundër që e konsideron se është kompetencë ekskluzive e saj. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se meqenëse Vendimi 01B/24 krijon kosto buxhetore për Komunën, kërkojnë nga MASHTI, t'i mbulojë ato, dhe shpenzime këto që kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimit/transportit të nxënësve dhe pagesën e orëve shtesë të mësimdhënësve. Më tej, parashtruesi i kërkesës i referohet rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke theksuar se ai fillimisht kishte dhënë rekomandime për Komunën, por rekomandimet e Avokatit të Popullit janë adresuar nga parashtruesi i kërkesës. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës, përmes kësaj përgjigje deklaroi se shpreh gatishmëri për zbatimin e këtij vendimi, me kushtin e mbështetjes financiare nga MASHTI, për (i) pagat shtesë për mësimdhënësit; dhe (ii) shpenzimet e transportit të nxënësve. Parashtruesi i kërkesës theksoi se nuk ka mjete në dispozicion për zbatimin e Vendimit të MASHTI [vendimit të kontestuar], andaj përkrahja është e domosdoshme.
35. Më 28 prill 2021, MASHTI përmes postës elektronike i përgjigjet parashtruesit të kërkesës, lidhur me shkresën e tij të 27 prillit 2021. MASHTI thekson se nuk krijohen shpenzime shtesë sepse mësimi zhvillohet në objektet shkollore më të afërta me vendbanimin e nxënësve. MASHTI poashtu kërkon nga parashtruesi i

kërkesës raport me dëshmitë e punës sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me pagesat e mësimdhënësve “*të cilët janë angazhuar mbi normën e përcaktuar me ligj*”.

36. Më 9 qershor 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Komunës së Kamenicës, përpiloi një raport, përmes të cilit u theksua se zyrtarët e DKA-së, kanë hasur në mësimdhënës (gjithsej pesë (5)) në fshatin Busavatë të cilët nuk janë pjesë e sistemit të arsimit në Komunën e Kamenicës dhe të cilët nuk gjenden në listën e pagave. Këta mësimdhënës kishin dhënë mësim pa kontratë të lëshuar nga ana e Komunës së Kamenicës.

Procedura gjyqësore e iniciuar nga prindërit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të parashtruesit të kërkesës për riorganizimin e shkollave

37. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se prindërit e disa fëmijëve që kanë vijuar mësimin në disa nga shkollat që janë riorganizuar me vendimet e parashtruesit të kërkesës, kanë refuzuar të i dërgojnë fëmijët e tyre për vijim e mësimi.
38. Për pasojë, disa nga ata prindër, kanë iniciuar konflikt administrativ përmes të cilit kanë kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe anulimin e vendimit e parashtruesit të kërkesës 02. nr.019870 të 10 shtatorit 2020.
39. Në shkresat e lëndës, Gjykata posedon 2 (dy) Aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës përkatësisht Aktgjykimin ARJ.UZVP.nr.22/2021 të 17 marsit 2021 dhe Aktgjykimin ARJ.nr.40/2021 të 21 prillit 2021. Këto vendime, kishin vendosur vetëm lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të parashtruesit të kërkesës 02. nr.019870 të 10 shtatorit 2020.
40. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ.nr. 40/2021 kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke arsyetuar se me asnjë provë bindëse nuk është arritur të dëshmohet se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar atyre do iu shkaktohet dëm, i cili vështirë do riparohej dhe shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i shkaktonte dëm të pa-riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-palës së interesuar. Në këtë çështje nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet ligjore ashtu siç parashihet me nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative.
41. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ.UZVP.nr.22/2021, gjithashtu refuzoi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke u bazuar poashtu në nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe duke përcaktuar që paditësit nuk kanë provuar se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ, do i'u shkaktohej dëm atyre, dëm ky i cili vështirë do riparohej; që shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe as që atyre shtyrja do i shkaktonte dëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.

Mbajtja e zgjedhjeve lokale

42. Më 17 tetor 2021, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës, ndërsa më 14 nëntor 2021, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës. Fitues në këto të fundit, për Komunën e Kamenicës ishte z. Kadri Rahimaj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar, ka shkelur nenin 12 [Pushteti Lokal], nenin 123 [Parimet e Përgjithshme], nenin 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 2 (Baza Kushtetuese dhe Ligjore e Vetëqeverisjes Lokale) dhe nenin 4 (Fushëveprimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
44. Parashtruesi i kërkesës më saktësisht pretendon se në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara përmes Kushtetutës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin në Komunitat, atij i janë shkelur kompetencat vetanake komunale.
45. Sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi i kërkesës thekson se Vendimi i kontestuar konsiderohet "Akt i Qeverisë" dhe i plotëson kushtet për t'u konsideruar i tillë, dhe rrjedhimisht, Komuna [parashtruesi i kërkesës] ka të drejtën të paraqesë këtë kërkesë bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, për arsye se Vendimi i kontestuar shkel në mënyrë të drejtpërdrejte kompetencën e komunës që me iniciativën e saj, bazuar në standardet e përcaktuara nga MASHTI, të ngritë cilësinë e arsimit në komunë.
46. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se Vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 12 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 17 paragrafi (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sepse bazuar në këtë dispozitë komuna, ka të drejtë të ofrojë arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se MASHTI (i) nuk ka kompetencë të organizojë mësim alternativ ose plotësues dhe këtë mund të kërkojë nga komuna që të organizojë në pajtimin me kërkesat e MASHTI; (ii) nuk ka kompetencë për të caktuar lokacionet e institucioneve arsimore e as të obligojë komunën që të mbajë mësim alternativ në institucione arsimore të palicencuara dhe të cilat për nevojat e ligjit ato nuk ekzistojnë edhe tutje si objekte shkollore.
47. Më tej, duke u mbështetur në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, parashtruesi thekson se MASHTI nuk ka përfillur këtë dispozitë ngase punësimi i mësimdhënësve është kompetencë ekskluzive e komunës, dhe MASHTI ka tejkaluar autorizimet e saj dhe ka hyrë në kompetencat e komunës. Në këtë linjë, parashtruesi i kërkesës shton se MASHTI nuk është organ i cili mund të lëshojë certifikata dhe dëftesa për nxënësit që kanë ndjekur procesin arsimor, ndërsa komuna s'mund ta bëjë këtë sepse nuk është organizatore.

48. Parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI ka rol monitorues dhe jo vendimmarës, dhe këtë argument e mbështetë në nenin 5 dhe nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI mund të kërkojë por në asnjë moment të nxjerrë Vendim me qëllimin e zbatimit të mësimin alternativ/shtesë. Për më shumë, parashtruesi i kërkesës thekson se me Vendimin e kontestuar të MASHTI-it janë shkelur dispozitat e Ligjit për Arsimin në Komuna, sepse neni 3, pika l), ka paraparë që përgjegjësi e Ministrisë është inspektimi i procesit arsimor. Ndërsa në nenin 4 është paraparë se Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa atë i takojnë interesit lokal. Ministria në rast se përmes mekanizmit të inspektimit, konsideron se ka nevojë për mësim shtesë/alternativ atëherë mund të nxjerrë rekomandim apo të paraqesë kërkesë për komunën.
49. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se me Vendimin e kontestuar (i) janë dëmtuar mësimdhënësit dhe nxënësit; dhe (ii) krijohet precedent i dëmshëm sepse dërgon mesazh negativ tek komunitat të cilat kanë nevojë të marrin masa për riorganizimin e shkollave.
50. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që të (i) deklarojë kërkesën e pranueshme dhe të njëjtën ta aprovojë; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 12, 123, 124 të Kushtetutës dhe neneve 2, 3, 4 dhe 9 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, e nenit 9 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, nenit 3 dhe 4 të Ligjit për Arsimin në Komunitat e Kosovës; dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Vendimin 01/B24, të MASHTI-it.

Kërkesa për masë të përkohshme

51. Parashtruesi i kërkesës, kërkon caktimin e masës së përkohshme për shkak të cenimit të përgjegjësi komonale dhe për shkak të ndikimit tek nxënësit, duke theksuar se (i) konsideron se kërkesa e tij është *prima facie* e bazuar; (ii) ka ofruar prova të mjaftueshme që do shkaktohet dëm i pa-riparueshëm sepse vendimi i kontestuar ia ka mohuar tij të drejtën për organizimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm qoftë edhe për mësimin alternativ, e drejtë kjo që i takon atij ekskluzivisht; Mbajtja e mësimin alternativ në institucione arsimore që janë ridestinuuar krijon dëm të pa-riparueshëm edhe për nxënësit që preken nga ky vendim sepse të njëjtit nuk mund të pajisen me dokumente (dëftesa) shkollore, dhe mbajtja e mësimin nga personat e paautorizuar të angazhuar nga MASHTI paraqet poashtu dëm të pa-riparueshëm sepse për të njëjtit nuk dihet çfarë përgatitje shkollore kanë dhe Komuna poashtu pëson dëm të pa-riparueshëm për shkak se disa nga mësimdhënësit që janë sistemuar në institucione arsimore sipas vendimeve për organizim, kanë dështuar t'i mbajnë orët e përcaktuara sipas kontratës; (iii) caktimi i masës së përkohshme është me interes publik, sepse nxënësit të përfshirë në këtë rast, do të iu ofrohej mundësi të arsimohen në shkollat e licencuara që ata të pajisen me dokumente përkatëse për vitin shkollor 2020/2021, dhe Komuna nëse vendoset masa e përkohshme, do angazhohej që

nxënësve përmes testeve dhe orëve shtesë t'u njihet e drejta për orët e mbajtura, duke i pajisur ata me dëftesa.

Komentet e subjekteve të interesuara dhe të parashtruesit të kërkesës

52. Gjykata në vijim do të paraqes komentet e (i) MASHTI; (ii) MAPL; dhe (iii) parashtruesit të kërkesës ndaj përgjigjeve të MASHTI-it dhe MAPL-së.

(i) Komentet e MASHTI-it

53. MASHTI në komentin e tyre të 31 gushtit 2021, theksoi se për shkak të Vendimit nr. 02/19870 të 10 shtatorit 2021 të parashtruesit të kërkesës, kanë qenë të pakënaqur 441 nxënës me ç'rast të njëjtit nuk kanë vijuar fare procesin mësimor, duke kundërshtuar kështu zbatimin e reformës. MASHTI më tej shton se përpos bojkotimit të procesit mësimor, prindër të këtyre fëmijëve kanë ushtruar padi përmes konfliktit administrativ dhe kanë kërkuar anulimin e Vendimit nr. 02/19870 të parashtruesit të kërkesës të 10 shtatorit 2021, si të kundërligjshëm dhe kanë kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij deri në vendosje meritore. Sipas informatave të MASHTI, Gjykata Themelore ka nxjerrë dy vendime me të cilat ka aprovuar kërkesën për shtyrje të Vendimit, ndërsa Gjykata e Apelit ka aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Për rrjedhojë, vendimet janë ankimuar në Gjykatë Supreme, dhe mbi 250 prindër janë tani në cilësinë e ndërhyrësit në padi. MASHTI pretendon se Gjykata e Apelit, ka nxjerrë vendim pa përgjigjen e propozuesve.
54. MASHTI, deklaron se duke konsideruar se një numër i madh nxënësish në shenjë revolte, privoheshin nga e drejta në edukim, asaj i është dashur të veprojë në mënyrë të domosdoshme. Lidhur me këtë pikë, MASHTI thekson se Inspektorati i Arsimit, në kuadër të funksioneve të përcaktuara nenin të Ligjit të Inspektoratit nr. 06/L -046, konstaton humbjet për nxënësit në procesin mësimor dhe rekomandon mënjanimin e humbjeve për nxënësit në raportet e 14 gushtit 2020 me ref. 10 me nr. 239, të 14 janarit 2020 me nr. 10/3 me nr. prot. 004/20, të 29 marsit 2021 me ref. 10/233 dhe të 30 marsit 2020 me ref. 10/237.
55. Nisur nga të lartcekurat, MASHTI deklaron se është vendosur lidhur me krijimin e një komisioni *ad hoc*, me qëllim të koordinimit në gjetjen e zgjidhjes lidhur me rastin. Komisioni përkatës konstaton se 441 nxënës apo 16% e numrit total të nxënësve në nivel komune nuk e kanë ndjekur procesin mësimor përgjatë një viti shkollor në katër institucione arsimore dhe dy vite në institucionin arsimor në Busavatë.
56. Rrjedhimisht, MASHTI thekson se ka nxjerrë vendim për organizimin e mësimit alternativ të përshpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës për nivelin fillor (I-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX), në mbështetje të nenit 26 paragrafi 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenit 28 paragrafi I nënparagrafi (e), nenit 3 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, nenit

22 dhe nenit 47 të Kushtetutës, nenit 3, nenit 5 dhe nenit 8 paragrafi 6.3 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, nenit 3 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 shtojca I paragrafi 7 i Rregullores (QRK) -nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e 30 marsit 2021 dhe nenit 9 paragrafi 7 të Udhëzimit administrativ (MASH) nr. 85/2020 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2020/2021.

57. Sipas MASHTI, Vendimi i kontestuar ka pasur për qëllim të kompensohen orët e humbura përmes organizimit të mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX). Vendimi parashih organizimin e procesit mësimor për 441 nxënësit nga 5 institucionet arsimore të cilët kanë refuzuar të ndjekin procesin mësimor si rezultat i refuzimit për zbatim të vendimeve të Kryetarit të Komunitetit të Kamenicës, vendime këto të cilat janë kontestuar në proces ligjor.
58. Sa i përket çështjes së mësimdhënësve, MASHTI deklaron se planprogrami dhe procesi mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit sipas pikës I të vendimit, të mos pengohen nga orari i mësimin që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga Komuna, dhe procesi mësimor organizohet nga vetë DKA në Komunitetin e Kamenicës, dhe sipas MASHTI, ky formulim në pikën 3 dhe 5 të Vendimit të kontestuar, garanton kompetencën e parashtruesit të kërkesës dhe obligimeve të saj, dhe të gjitha komunikimet me parashtruesin e kërkesës iu është ofruar mbështetje në zbatim të vendimit.
59. MASHTI, pohon se bazuar në nenin 22 dhe 53 të Kushtetutës, dhe duke vënë theks tek neni 2 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së lidhur me të drejtën në edukim, thekson se e njëjta garanton të drejtën e çdo individit në edukim, por e drejtë kjo që implikon edhe përgjegjësi të caktuara për shtetin, që të garantohet një drejtë e tillë. Në rastin konkret, MASHTI pohon se marrë parasysh protestimin e prindërve dhe mohimin e edukimit që iu bëhet fëmijëve në shenjë revolte, MASHTI ka tentuar që me vendimin e kontestuar, të kthejë të drejtën e fëmijëve për edukim të mirëfilltë.
60. Më tej, MASHTI i referohet rasteve të GJEDNJ-së (*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*); (*Leyla Sahin kundër Turqisë*, paragrafi 154 dhe 155), duke theksuar se pa paragjykuar veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës, në drejtim të reformimit të sistemit arsimor, dhe duke u nisur nga rrezikimi i mohimit të drejtës në edukim, konsideron se përmes Vendimit të kontestuar, ka vepruar në pajtim me obligimet shtetërore dhe ka ndërhyre me përgjegjësi të pritshme në qëllim të parandalimit të humbjes në arsim gjë e cila drejtpërdrejtë ndikon në ushtrimin e së drejtës në edukim sipas KEDNJ-së. MASHTI konsideron se i takon Gjykatës Kushtetuese të vendosë në çfarë mase Komuna e Kamenicës ka respektuar parimin e proporcionalitetit, dhe konsideron se ishte përgjegjësi e MASHTI-it të sigurojë kompensimin e orëve të humbura mësimore, që të mos lejojë deprivimin e ushtrimit të së drejtës në edukim.

61. MASHTI thekson se neni 2 i Protokollit nr.1 duhet lexuar edhe në dritë të neneve 8, 9 dhe 10 të KEDNJ-së, dhe me këtu citon rastet e GJEDNJ-së (*Folgem dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, paragrafi 84) dhe (*Catan dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë*, paragrafi 143), si dhe (*Enver Sahin kundër Turqisë*, paragrafi 72). Në vazhdim, MASHTI thekson se neni 2 i Protokollit Nr.1 është po ashtu i lidhur me nenin 14 të KEDNJ-së dhe rrjedhimisht, ndalimit të diskriminimit, dhe poashtu thekson se e drejta në edukim i referohet edhe qasjes në institucionet e edukimit, shkëmbim të dijes dhe zhvillim intelektual (*Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 33). Më tej, MASHTI thekson se çdo shtet është i obliguar që të ndërtojë institucione të edukimit dhe të sigurojë qasje efektive ndaj këtyre institucioneve (*Leyla Sahin kundër Turqisë* [DHM], paragrafët 136-137). Me fjalë të tjera, qasja në institucionet e edukimit në të caktuar bën pjesë integrale në fjalinë e parë të nenit 2 të Protokollit Nr.1 që garanton të drejtën në edukim (*Morsel Eren kundër Turqisë*, paragrafi 41; *Irfan Temel dhe të tjerët kundër Turqisë*, paragrafi 39).
62. MASHTI konsideron se marrë parasysh të lartcekurat, dhe pa paragjykuar kompetencat e Komunës së Kamenicës [parashtruesit të kërkesës] në kuptim të sigurimit të zhvillimit të arsimit në këtë Komunë, konsideron që është obligim i shtetit, në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që të sigurojë implementimin e garantimit të së drejtës në edukim, duke ofruar edhe, si pjese integrale e kësaj të drejte, qasje në institucionet e edukimit të ndërtuara dhe të autorizuar për po këtë qellim.
63. MASHTI argumenton që sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, parashihet (i) në nenin 3 obligimi në sigurimin e arsimit parauniversitar, duke ndaluar shprehimisht mohimin e te drejtës në arsim; dhe (ii) theksohet se "*është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë*" sigurimi i arsimit parauniversitar. Në kontekstin aktual, MASHTI thekson se nuk mund të mos theksohet që protestimi prindërve dhe rrjedhimisht mohimi i të drejtës në edukim për fëmijët, si pasojë e veprimeve të parashtruesit të kërkesës nuk mund të trajtohej në mënyrë të heshtur nga MASHTI, rrjedhimisht nga shteti.
64. Më tutje, lidhur me aspektin procedural, MASHTI thekson se duke u bazuar në nenin 113 paragrafi 4 i Kushtetutës, në rastin konkret baza ligjore mungon, sepse MASHTI në asnjë mënyrë nuk ka cenuar përgjegjësi komunale dhe nuk ka zvogëluar të hyrat komunale. MASHTI konsideron se këto janë kompetenca sipas Kushtetutës dhe janë përgjegjësi shtetërore dhe jo komunale e që me asnjë veprim të saj MASHTI nuk ka ndërhyrë në kompetencat e parashtruesit të kërkesës kur ka lejuar "*qasje në shkolla sepse kjo e fundit është pjesë thelbësore e së drejtës në edukim*".
65. Më tej, MASHTI konsideron se vendimi i kontestuar, nuk ka ndikuar fare në zvogëlimin e të hyrave të komunës, dhe ky vendim është vendim i MASHTI-it dhe jo i qeverisë si vendim kolegjal. MASHTI konsideron se vendimi i Qeverisë përbën shkallë të dytë për vendimet e Ministrisë sipas procedurës administrative të përcaktuar nga Ligji për Procedurën Administrative, Ligji nr. 05/L -031, neni 128

ku theksohet se "Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, një ankesë kundër një akti administrativ, mund t'i drejtohet organit publik që ka nxjerrë apo ka kompetencë të nxjerre aktin (në tekstin ne vijim: organi kompetent), apo organit publik mbikëqyrës të organit kompetent, apo një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj (në vijim të dy këta të fundit: "organi epror"). Nëse ankesa i është drejtuar organit epror, ai ia përcjell, pa vonesë organit kompetent". Udhëzimi administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe Rregullores nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, përcaktojnë qartë një ndarje në mes të akteve të Qeverisë dhe Ministrive të linjës.

66. Në këtë rast, MASHTI thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar ankesë ndaj aktit administrativ sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127, paragrafi 1, ku theksohet se "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ". Po ashtu, MASHTI konsideron se preambula e vendimit thekson se vendimi bazohet në kompetencat e saj sipas Rregullores së Qeverisë 02/2021, neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, shtojca I. Ndërsa, vendimet e Qeverisë kanë bazë tjetër ligjore, përkatësisht nenit 4 të kësaj rregullore. Me këtë rast, MASHTI konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural në atakimin me mjete juridike ndaj aktit administrativ. Ky akt është si akt administrativ dhe jo si akt rregullativ me bazë ligjore në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.
67. Më tej, lidhur me efektin financiar të aktit, në vendim nuk i ngarkohet asnjë shpenzim shtesë për parashtruesin e kërkesës. Në asnjë nga pikat e vendimit nuk krijohen shpenzime shtesë për parashtruesin e kërkesës. Asnjë nga mësimdhënësit nuk ka kërkuar kompensim shtesë në angazhimin e tyre. Tekstet shkollore janë kërkuar nga Komuna për këta fëmijë sipas ndarjes në shkollat specifike. Ministria ka siguruar material higjenik dhe mbështetës sipas kërkesave të situatës së pandemisë. Ministria në kuadër të ndarjes së buxhetit e bën për kokë të nxënësit. Parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë asnjë dëshmi që janë krijuar shpenzime shtesë edhe pasi vendimi është ekzekutuar. Andaj, mbështetur në këtë kërkesa është e papranueshme. Lidhur me kërkesën për pezullim të ekzekutimit të vendimit, vendimi është nxjerrë me 23 prill 2021 dhe ka filluar të ekzekutohet nga 04 maji 2021 deri me 31 korrik 2021. Andaj, kërkesa për pezullim të vendimit të ekzekutuar nuk mund të aplikohet. Pezullimi aplikohet për vendimet të cilat do të zbatohen apo janë në zbatim. Lidhur me argumentimin mbi urgjencën për veprim, Komuna e Kamenicës vetëm pas pesë muajve sjell rastin pranë Gjykatës kur vendimi është ekzekutuar dhe ka realizuar pasoja juridike.
68. MASHTI në fund konsideron se (i) argumentet në lidhje me meritat e kërkesës për vlerësim e kushtetutshmërisë të vendimit të kontestuar, nuk janë të bazuara *prima facie*; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur rastin *prima facie* për meritat e kërkesës për masë të përkohshme dhe pretendimi lidhur me urgjencën nuk qëndron sepse vendimi tashmë është ekzekutuar dhe ka krijuar pasoja juridike, dhe ky vendim ka filluar të ekzekutohet nga 23 prilli 2021 e deri 31 korrik 2021; (iii) kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës konsiderohet e parakohshme, për

shkak të mos-shterimit të mjeteve juridike; (iv) 441 fëmijë e kanë ndjekur dhe e kanë përfunduar procesin mësimor dhe asnjë shpenzim shtesë nuk është krijuar për parashtruesin e kërkesës, dhe thekson se një rast i ngjashëm është edhe vendimi i 20 prillit 2021 me nr. 01/B 603, lidhur me organizimin e mësimin plotësues që kanë pasur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19, për të cilin nuk është paraparë buxhet shtesë si rezultat i mos krijimit të shpenzimeve shtesë.

(ii) Komentet e MAPL-së

69. MAPL në komentet e saj të 31 gushtit 2021, së pari theksoi se sipas nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale kompetencë vetanake e komunave është ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit.
70. Megjithatë, MAPL më tej konsideron se Vendimi i kontestuar, është në përputhje të plotë me kompetencat e MASHTI-it dhe duke respektuar, ndër dispozitat e tjera edhe bazën ligjore siç është e paraparë në Ligjin për Arsimin, përkatësisht nenin 3, 5 dhe për t'u konkretizuar me tutje bëhet fjalë për një vendim i bazuar në nenin 8 paragrafin 6.3, dispozitë e cila ka të bëjë pikërisht me kompetencën e Ministrisë që të kërkoj zbatimin e mësimin shtesë ose alternativ, në rastet kur vërehen mangësi në zbatim të kurrikulimit. Pikërisht, një situatë e tillë edhe është paraqitur në rastin konkret në Komunën e Kamenicës.
71. Në këtë kuptim, vlerësojmë se Vendimi i kontestuar dhe zbatimi i tij, në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet ndërhyrje në kompetencat vetanake të Komunës së Kamenicës [parashtruesit të kërkesës] për organizimin e procesit mësimor, por është në përputhje të plotë dhe në funksion të realizimit të të drejtave kushtetuese të fëmijëve për arsimim.

(iii) Komentet e parashtruesit të kërkesës ndaj komenteve të MASHTI dhe MAPL-së

72. Duke u bazuar në shkresën e Gjykatës, për mundësinë e ofrimit të komenteve lidhur me komentet e parashtruara nga MASHTI dhe MAPL, parashtruesi i kërkesës dorëzoi edhe komentet e tij.
73. Fillimisht parashtruesi i kërkesës, thekson se nuk e konteston parimin që buron nga neni 3 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar, sepse edhe ai vetë ka ndërmarr veprime në drejtim të riorganizimit të sistemit arsimor me qëllim të ofrimit të shërbimeve efikase, efektive gjithëpërfshirëse, për t'i ofruar fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës konteston komentin e MAPL-së, sepse thekson se kjo dispozitë nuk i jep kompetencë MASHTI-it dhe se e njëjta me Vendimin e kontestuar ka ndërhyrë në kompetencat e parashtruesit të kërkesës.
74. Parashtruesi i kërkesës më tej, nuk i konteston kompetencat e MASHTI, lidhur me nenin 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, mirëpo organizimi i mësimin

alternativ apo shtesë, nuk parashihet me këtë nen. Sa i përket nenit 8 paragrafit 6, nënparagrafit 6.3, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, parashtruesi i konsideron se MASHTI, ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë sepse e njëjta ka mundur të kërkojë organizimin e mësimit shtesë apo alternativ nga parashtruesi kërkesës, përmes kërkesës/rekomandimit, siç e parasheh kjo dispozitë e jo të nxjerrë vendim lidhur me të. Parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë apo alternativ por nuk ka rol vendimmarrës në organizimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

75. Parashtruesi i kërkesës i referohet edhe Opinioni ligjor nga MAPL, i lëshuar me 22 gusht 2020, përmes të cilit arrihet në përfundim që arsimi publik parashkollor, fillor dhe i mesëm është kompetencë ekskluzive e Komunave sipas nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi (h) i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
76. Parashtruesi i kërkesës, nuk u pajtua me komentet e MASHTI duke i kategorizuar argumentet e tij në 5 (pesë) kategori: (i) Përfaqësuesi i Komunës së Kamenicës nuk është pajtuar me rekomandimet e Komisionit *ad-hoc* të themeluar sipas Vendimit me nr. të Protokollit 01B/14 që nxënësit të kthehen për mësim plotësues në shkollat ku kanë qenë më herët duke vijuar mësimin; (ii) Komentet në lidhje me procedurën gjyqësore të prindërve të hapur përmes konfliktit administrativ; (iii) Komentet në lidhje me bazën ligjore mbi bazën e të cilës është nxjerrë Vendimi i kontestuar dhe efektet Financiare të Vendimit të Kontestuar; (iv) Komentet në lidhje me Vlerësimin që kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë e parashtruesit të kërkesës është e parakohshme për shkak të mos ndjekjes së procedurave në gjykata të rregullta; (v) Komentet në lidhje me masën e përkohshme.
77. Lidhur me pikën (i) parashtruesi thekson se përfaqësuesi i Komunës, zyrtar i DKA-së, nuk është pajtuar me rekomandimet e Vendimit 01/B/14 të Komisionit *ad-hoc*, dhe se i njëjti komision, nuk i ka rekomanduar MASHTI-it, që vetë të bëjë organizimin e mësimit plotësues mirëpo ka rekomanduar që të ndër marrë veprime të harmonizuara me autoritetet e Komunës. Parashtruesi i kërkesës thekson se si Komunë, kanë shprehur gatishmërinë për mbajtjen e mësimit plotësues, por jo në institucione arsimore që nuk janë duke funksionuar më dhe nuk kanë as kushtet elementare sanitare për zhvillimin e mësimit në to.
78. Lidhur me pikën (ii) për procedurën gjyqësore të hapur kundër vendimeve të parashtruesit të kërkesës, thekson se nuk është kontestuese që prindërit e fëmijëve që kanë bojkotuar procesin mësimor, kanë iniciuar konflikt administrativ (lidhur me këtë parashtruesi ka bashkangjitur edhe dy Aktgjykime të Gjykatës Supreme). Parashtruesi thekson se bazuar në Opinioni ligjor të lëshuar nga MAPL të 22 gushtit 2020, vendimet e marra nga ai, kanë kaluar procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë.
79. Më tej, lidhur me pikën (iii) parashtruesi i kërkesës thekson se fillimisht nuk qëndron argumentimi nga MASHTI se Vendimi i kontestuar përbën akt individual, dhe thekson se bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, komuna mund të

parashtrojë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Tutje, lidhur me efektet financiare të Vendimit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës, thekson se ka pasur zvogëlim të hyrave në mënyrë direkte *“për shkak se përveç që i janë cenuar përgjegjësitë, të njëjtës i janë shtuar obligime financiare që ndër të tjera janë: Energjia Elektrike si kosto shtesë për objekte të përcaktuara nga vetë Ministria dhe jo nga parashtruesi i kërkesës”*. Sipas pretendimit, MASHTI ka angazhuar mësimdhënës të cilët nuk janë të punësuar pranë parashtruesit të kërkesës, e që sipas parashtruesit kjo vërtetohet me raportin sipas provës nr. 12 të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës, poashtu pretendon se në institucionet arsimore të përcaktuara me Vendimin e kontestuar, të njëjtat janë institucione që nuk ekzistojnë praktikisht dhe ligjrisht, dhe ato janë riorganizuar dhe nuk janë të licencuara dhe nuk ofrojnë kushte për mbajtjen e mësimi. Këto institucione arsimore nuk kanë *“as licencë, as mësimdhënës, as mirëmbajtje dhe asnjë kusht që procesi mësimor të zhvillohet”*.

80. Përkitazi me pikën (iv), parashtruesi i kërkesës thekson se nuk qëndron pohimi i MASHTI-it se parashtruesi i kërkesës është dashur të paraqesë ankesë kundër Vendimit të kontestuar dhe kërkesa e parashtruesit të kërkesës bazohet në Kushtetutë dhe në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.
81. Në fund, sa i përket pikës (v), parashtruesi i kërkesës konsideron se ekziston dëmi i pa-riparueshëm sepse 441 nxënës nuk do pajisen me diploma përkatëse, për shkak të Vendimit të kontestuar, dhe sipas tij ekziston rreziku që MASHTI të vazhdojë të ndërhyjë në mënyrë të kundërligjshme në kompetencat e parashtruesit të kërkesës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 113

[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

[...]

Neni 12

[Pushteti Lokal]

1. Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.

2. Organizimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj.

Neni 123 **[Parimet e Përgjithshme]**

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.

2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysht dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.

4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 **[Organizimi dhe Funkionimi i Vetëqeverisjes Lokale]**

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.

3. Komunitetet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.

4. Komunitetet kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.

5. Komunitetet kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.

7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale

Neni 2

[Baza kushtetuese dhe ligjore e vetëqeverisjes lokale]

Parimi i vetëqeverisjes lokale do të njihet në legjislacionin e brendshëm, dhe aty ku është praktike në kushtetutë.

Neni 3

[Koncepti i vetëqeverisjes lokale]

1. *Vetëqeverisja lokale nënkupton të drejtën dhe mundësinë e autoriteteve lokale që brenda kufirit ligjor, të rregullojnë dhe menaxhojnë një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë lokale.*

[...]

Neni 4

[Fushëveprimi i vetëqeverisjes lokale]

1. *Kompetencat dhe përgjegjësitë themelore të autoriteteve lokale do të përcaktohen me kushtetutë ose me ligj. Sidoqoftë, kjo dispozitë nuk do të parandalojë dhënien kompetencave dhe përgjegjësiive autoriteteve lokale për qëllime të veçanta në përputhje me ligjin.*

2. *Autoritetet lokale, brenda kufijve të ligjit, do të kenë diskrecionin e plotë për të ushtruar iniciativën e tyre në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre dhe nuk i është caktuar ndonjë autoriteti tjetër.*

3. *Përgjegjësitë publike duhet në përgjithësi të ushtrohen, në preferencë, nga autoritetet më të afërta me qytetarët. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomizimit.*

4. *Kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive. Ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal përveç siç përcaktohet me ligj.*

5. Në rast se kompetencat i kalojnë një autoriteti qendror apo rajonal, autoriteteve lokale duhet të gëzojnë, brenda mundësisë, lirinë që ushtrimin e tyre t'ia përshtatin kushteve lokale.

6. Autoriteteve lokale duhet t'u kërkohet mendimi brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet që u përkasin atyre drejtpërsëdrejti.

Neni 8

[Kontrolli administrativ i veprimeve të autoriteteve lokale]

1. Çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji.

2. Çdo kontroll administrativ i veprimeve të autoriteteve lokale normalisht duhet të synojë sigurimin e respektimit të ligjshmërisë dhe të parimeve kushtetuese. Kontrolli administrativ mund, megjithatë të kuptojë një kontroll të ushtruar nga autoritete të nivelit më të lartë lidhur me detyrat, zbatimin i të cilave i është kaluar autoriteteve lokale.

3. Kontrolli administrativ i autoriteteve lokale duhet të ushtrohet duke respektuar proporcionalitetin mes rëndësisë së ndërhyrjes së autoritetit kontrollues dhe rëndësisë së interesave që ai kërkon të mbrojë.

LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

KREU III KOMPETENCA KOMUNALE

Neni 3 Përkufizimet

[...]

- "Kompetencat vetanake"- do të thotë kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin.

[...]

Neni 15 Parimi i subsidiaritetit

Komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit.

Neni 16

Kompetencat komunale

Komunat i ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin.

Neni 17 Kompetencat vetanake

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;*
- b) planifikimin urban dhe rural;*
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;*
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;*
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;*
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;*
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;*
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;*
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;*
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;*
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;*
- l) banimin publik;*
- m) shëndetësinë publike;*
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;*
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;*
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;*
- q) turizmit;*
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira;*
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër;*

LIGJI NR. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 3 Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.
2. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.
3. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.
4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.
5. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të:
 - 5.1. respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi;
 - 5.2. kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë, dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve.
6. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinionëve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

7. Institucionet publike arsimore duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagandojnë një fe të caktuar.

8. Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësive të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.

Neni 5 Detyrat e Ministrisë

1. Ministria mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe ka detyrat e përgjithshme që:

1.1. të zhvillojë politika, hartojë dhe zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar;

1.2. të përcaktojë rezultatet e niveleve të ndryshme të arsimit dhe aftësimin parauniversitar si dhe të japë kualifikime, ose të autorizojë dhënien e tyre, për të gjithë ata që me sukses i përfundojnë programet parauniversitare sipas niveleve përkatëse të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;

1.3. të promovojë sistem jo diskriminues, të arsimit në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor;

1.4. të promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimin; të sigurojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të punësuarve në institucionin arsimor dhe aftësues, si dhe të avancojë masat për parandalimin e braktisjes;

1.5. të vendosë kritere dhe të menaxhojë një sistem të licencimit të mësimdhënësve, përmes Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, të themeluar sipas këtij ligji;

1.6. të vendosë dhe mirëmbajë një sistem të informatave për menaxhimin e arsimit dhe aftësimin.

1.7. t'i ofrojë komisionit për grante në baza vjetore të dhëna të mjaftueshme dhe standarde të formulës me qëllim të përcaktimit të grantit specifik për arsim në përputhje me ligjin në fuqi dhe dispozitat e nenit 28 të këtij ligji;

1.8. të dizajnojë dhe mbikëqyrë format efektive të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për t'u zbatuar nga

komunat dhe përcaktojë kritere dhe procedura të monitorimit të punës së Këshillit Drejtues;

1.9. të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimin përmes mekanizmave të cekura në nenin 8 të këtij ligji për inspektim, monitorim, dhe vlerësim me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi;

1.10. të përcaktojë kriteret për vlerësimin dhe notimin e nxënësve në institucionet arsimore dhe aftësuese;

1.11. të organizojë dhe të menaxhojë vlerësimin e jashtëm për nivelet 1, 2 dhe 3 të ISCED-it në përputhje me kërkesat për dhënien e kualifikimeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe, sipas nevojës, duke u konsultuar me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve;

1.12. të sigurojë politika gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me nevoja të veçanta;

1.13. të promovojë pjesëmarrjen dhe partneritetin e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe aftësuese përmes Këshillit të Prindërve të Kosovës, organeve udhëheqëse të institucioneve arsimore dhe aftësuese dhe përmes mënyrave tjera;

2. Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore lidhur me:

2.1. kalendarin shkollor dhe periudhën kohore të vitit shkollor në kuadër të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës,

2.2. kohëzgjatjen e orës së mësimi dhe pushimeve shkollore, festat,

2.3. numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe proporcionin e numrit nxënës-mësimdhënës (klasat apo shkollat që japin mësim në gjuhët jozyrtare mund të themelohen edhe me numër më të ulët, sesa ai i paraparë në kushte të zakonshme),

2.4. provimet dhe vlerësimet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ministria nxjerr akte nënligjore në lidhje me regjistrimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e arsimit, duke marrë parasysh kriteret në vijim:

3.1. dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet e arsimit, si dhe nga ato të aftësimi duhet të përmbajnë të dhënat personale, si vijon : emri, emri i prindit-kujdestarit ligjor, mbiemri dhe data e lindjes;

3.2. dokumentet zyrtare duhet të lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare; nxënësi i arsimuar në gjuhën jozyrtare ka të drejtën që përveç në gjuhët zyrtare, dokumentet e veta zyrtare t'i ruhen dhe lëshohen edhe në gjuhën e tij të mësimi;

3.3. të dhënat personale që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike e fetare mund të evidencohen vetëm për shkaqe të monitorimit statistikor që ndihmon në promovimin mundësive të barabarta, dhe nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër. Të dhënat e tilla nuk mund të regjistrohen në ndonjë mënyrë përmes së cilës individët mund të identifikohen si të tillë.

4. Në kuadër të raportit vjetor të qeverisë, Ministria raporton për arsimin parauniversitar, si dhe për zbatimin e këtij ligji para Kuvendit në fund të vitit kalendarik.

5. Ministria emërton dhe riemërton institucionet publike arsimore dhe aftësuese në bazë të rekomandimit nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) përkatëse në bazë të propozimeve të bëra nga këshilli drejtues i institucionit arsimor apo aftësues, e që mund të jenë deri në tri propozime.

6. Ministria përcakton kodin unik të çdo institucioni arsimor apo aftësues, i cili përdoret në sistemin e menaxhimit të informatave arsimore.
[...]

8. Përmes një akti nënligjor, Ministria miraton standardet e licencimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese, përfshirë edhe standardet e cekura në paragrafin 7. të këtij neni.

9. Ministria licencon dhe akrediton institucione që ofrojnë kualifikime të përgjithshme sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në bazë të kritereve dhe standardeve të përcaktuara për këtë qëllim; institucionet që ofrojnë lloje të tjera të kualifikimeve akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, në bazë të kritereve dhe standardeve të përcaktuara për këtë qëllim dhe licencohen nga Ministria.

10. Ministria vepron si organ i shkallës së dytë për vendimet e organeve të tjera arsimore dhe aftësuese, ku e drejta e ankesës përcaktohet në këtë ligj.

Neni 7 **Kompetencat e komunës**

1. Kompetencat e komunave janë të rregulluara përmes:

- 1.1. Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/LO40, të datës 20 Shkurt 2008, dhe Ligjit për arsim në komuna, nr. 03/L-068, të datës 21 maj 2008, dhe
- 1.2. kompetencave shtesë të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Ushtrimi i përgjegjësive dhe detyrave të komunës në këtë fushë monitorohet nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi.

3. Komunat kanë përgjegjësitë shtesë në vijim:

3.1. ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese;

3.2. mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore;

3.3. sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjieniko sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurisë efektive.

3.4. përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritetet e tjera publike, marrin hapa për të adresuar sjelljet e dhunshme dhe keqpërdorimin në ose në lidhje me institucionin përkatës.

Neni 8 **Inspektimi i arsimit**

1. Inspektimi i institucioneve arsimore dhe aftësuese për qëllimin e specifikuar në nën-paragrafin 1.9. paragrafi 1. të nenit 5 të këtij ligj i është përgjegjësi e Departamentit të Inspektionit pranë Ministrisë.

2. Autoriteti për inspektim buron nga Ministria; drejtorët e institucioneve arsimore dhe aftësuese dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të bashkëpunojnë me inspektorët e autorizuar duke ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshme, qasje në institucion, si dhe të marrin pjesë në inspektim personalisht apo përmes zëvendësit të autorizuar.

3. Inspektimi duhet të organizohet në cikle vjetore të planifikimit, me mundësi të inspektimit të veçantë në kushtet e përcaktuara nga Departamenti i Inspektionit.

4. Qëllimet e inspektimit të funksionimit të institucionit arsimor dhe aftësues në nivelin 0, 1, 2, 3 dhe 4 të ISCED-it janë që së bashku me inspektorët të fushave të tjera (punësimi, shëndetësia, ndërtimi, financat etj) të kontrollojnë dhe evidentojnë:

4.1. respektimin e detyrave dhe funksioneve përkatëse të institucionit në përputhje me këtë ligj si dhe ligjet tjera dhe aktet nënligjore;

4.2. funksionimin e këshillit drejtues të institucionit, funksionimin e këshillit të prindërve dhe këshillit të nxënësve, korrektësinë në të dhënat e nxënësve sipas niveleve dhe klasave, saktësinë në dokumentet pedagogjike dhe shkollore, organizimin e mësimi;

4.3. numrin, kualifikimet dhe mundësitë për zhvillim profesional të mësimdhënësve;

4.4. ambientin e punës duke përfshirë respektimin e standardeve të shëndetësisë dhe sigurisë, të dhënat e evidentuara të veprimeve disiplinore dhe rezultatet e tyre;

4.5. zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kurrikulimit duke përfshirë kurrikulumin bërthamë, kurrikulumin me bazë shkolle, procedurat e testimit dhe vlerësimit, përdorimin e teksteve të miratuara dhe materialet mësimore;

4.6. dhe, në rastet kur evidentohet moszbatim i aspekteve të mësipërme, drejtorit të institucionit në fjalë i jepen rekomandime dhe këshilla specifike për ndryshimet e nevojshme në një afat të caktuar.

5. Nëse drejtori nuk merr masa të nevojshme për të adresuar mangësitë në fushat e cekura më lartë në paragrafin 4. të këtij neni, inspektori mund të përcaktojë procedurat disiplinore që duhet të merren ndaj drejtorit apo personelit tjetër në institucion.

6. Pas raportit të inspektorit, i cili nënshkruhet nga inspektori dhe drejtori i institucionit përkatës:

6.1. Ministria mund të ndërpresë punën e institucioneve arsimore dhe aftësuese të cilat nuk janë të licencuara apo veprojnë në ambiente të pasigurta dhe të pashëndetshme.

6.2. Ministria mund të udhëzojë komunën që të ndërpresë marrëdhënien e punës së një mësimdhënësi që është punësuar në kundërshtim me kriteret e specifikuar në këtë ligj, ose është përjashtuar nga puna për shkak të kushteve mjekësore ose urdhrat të gjykatës apo dispozitat e këtij ose ligjeve të tjera në fuqi kërkojnë një gjë të tillë;

6.3. në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulimit, Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimin shtesë ose alternativ.

6.4. Ministria mund të anulojë notat në rastet kur nuk janë respektuar procedurat e vlerësimit si dhe diplomat dhe dokumentet tjera që janë marrë në kundërshtim me këtë ose ligjet tjera në fuqi.

7. Departamenti i Inspektimit gjithashtu ka përgjegjësinë të monitorojë dhe vlerësojë punën akademike të institucionit si pjesë e ciklit vjetor të inspektimit. Ministria, në konsultim me Agjencionin e Kosovës për Kurrikul Standarde dhe Vlerësim përcakton kritere dhe procedura për inspektim kombëtar që mund të përfshijë ekspertë në disa fusha specifike akademike ose profesionale në përputhje me paragrafin 4. të nenit 25 të këtij ligji.

8. Ankesat ndaj vendimeve ose veprimeve të Inspektorit mund të bëhen pranë Komisionit për ankesa në Ministri.

Neni 14

Caktimi i nxënësve nëpër institucionet arsimore

[...]

9. Kalimi i obligueshëm prej një shkolle në tjetrën në rastet kur kjo duhet të bëhet për të mirën e nxënësve të tjerë rregullohet përmes dispozitave të këtij ligji.

LIGJI NR. 03/L-068 PËR ARSIMIN NË KOMUNATE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT) ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) të zhvillojë politika dhe të hartoi e implementojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencën në Kosovë;
- b) të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim dhe mundësitë e shkollimit cilësor të vihen në dispozicion për të gjithë;
- c) të krijojë dhe menaxhojë një sistem të përgjithshëm të certifikimit për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë;
- d) të përhapë arsimin jo-formal dhe arsimin për të rritur në të gjitha nivelet, duke përfshirë zonat e thella dhe të promovojë mundësitë e shkollimit gjatë gjithë jetës për të gjithë;
- e) të dizajnojë, implementojë dhe mbikëqyr forma të barasvlershme dhe efikase të administrimit arsimor dhe menaxhimit shkollor;
- f) të përmirësojë cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin arsimor në të gjitha nivelet;
- g) të lehtësojë zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe ofrimin efikas të shërbimeve arsimore;
- h) të promovojë hulumtimet në lidhje me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës;
- i) të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës të bibliotekave Universitare dhe shkollore;
- j) të promovojë një politikë përfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor; dhe
- k) të promovojë pjesëmarrjen e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe format e duhura të partneriteteve shkollë-komunitet në nivelin lokal;
- l) inspektimin e Arsimit.

Neni 4

Kompetencat dhe Kompetencat e Zgjeruara të Komunave

4.1 Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve.

4.2 Përveç kompetencave të referuara në Paragrafin 1 të këtij Neni, Komunave mund t'iu jepen kompetenca të zgjeruara në fushën e arsimit, ashtu si përshkruhet nga ky ligj dhe ligjet e tjera në fuqi.

4.3 Në pajtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komuna të tjera dhe autoritete të tjera, brenda sferës të kompetencave të veta në fushën e arsimit. Kjo e drejtë përfshin bashkëpunimin me komunat dhe institucionet në Republikën e Serbisë, duke përfshirë agjensionet qeveritare.

Neni 5

Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë)

Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:

a) ndërtimin e objekteve shkollore në pajtueshmëri me Kapitullin 3 të këtij ligji dhe me ligjet e tjera në fuqi;

b) regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mos-diskriminimit sipas ligjit;

c) punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë;

d) zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin e te dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtar do të jënë nga Komuna dhe një nga MASHTI-i;

e) regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore parashkollore, në pajtim me Kapitullin 4 të këtij ligji;

- f) pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin e Kosovës;
- g) trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional në pajtim me udhëzimet, parimet dhe standardet e shpallura nga MASHT-i;
- h) mbikëqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i;
- i) përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësime të personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore;
- j) raportimin të qeveritë lokale dhe MASHT-i rreth arsimit, veprimtarive buxhetore dhe menaxhuese për nivelin parashkollor në pajtim me legjislacionin komunal dhe qendror;
- k) aplikimin e këtyre funksioneve apo kompetencave të deleguara, ashtu si përcaktohet nga marrëveshja formale mes komunës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- l) monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu si përcaktohet nga legjislacioni; dhe
- m) caktimin e shumave të participimit të prindërve për pranimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte në pajtim me ligjet e Kosovës.

RREGULLORE (QRK) - NR. 02/2021 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE

**Neni 8
Ministri**

1. Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri:

[...]

1.4. Nxjerr vendime, akte nënligjore dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë; dhe

1.5. Kryen detyra të tjera në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

[...]

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

82. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

83. Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

84. Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 4, të Kushtetutës, që përcakton:

“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose akteve të qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt”.

85. Gjykata merr parasysh nenet 40 [Saktësimi i kërkesës] dhe 41 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

*Neni 40
[Saktësimi i kërkesës]*

Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.”

*Neni 41
[Afatet]*

Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës”

86. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 73 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës] të Rregullores së punës, që specifikon:

*Rregulli 73
[Kërkesa në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës]*

“(1) Kërkesa, e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit.

(2) Në kërkesën e parashtruar sipas këtij rregulli, komuna duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) informatat relevante në lidhje me ligjin ose me aktin e kontestuar të Qeverisë;

(b) dispozitën specifike të Kushtetutës e cila pretendohet se është shkelur; dhe

(c) përgjegjësitë ose të ardhurat e komunës që janë prekura nga ky ligj ose akt.

(3) Kërkesa, sipas këtij rregulli duhet të paraqitet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës së ligjit ose të aktit të kontestuar të Qeverisë”.

87. Megjithatë, para vlerësimit të kushteve të lartcekura, Gjykata së pari, rikujton se me 5 janar 2022, Kryetari i Komunës së Kamenicës Kadri Rahimaj, i përfaqësuar nga Alban Hashani nga Kamenica, ka pranuar kërkesë për tërheqjen e kërkesës KO145/21 në Gjykatë, duke theksuar se Komuna e Kamenicës “*nuk ka asnjë interes juridik*” për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar. Kryetari i Komunës, bazohen në paragrafin 1 të nenit 35 të Rregullores së Punës.
88. Për pasojë, Gjykata fillimisht do shqyrtojë kërkesën për tërheqje të Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

(i) Kërkesa për tërheqje të kërkesës

89. Me këtë rast Gjykata rikujton paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 35 të Rregullores së Punës i cili përcakton:

Rregulli 35

Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës

(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën.

(3) Në rast se Gjykata përcakton të vendosë për një kërkesë të tillë, ajo vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara, dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj.

[...]

90. Gjykata rikujton se kërkesa KO145/21, është dorëzuar nga kryetari Komunës së Kamenicës z. Qëndron Kastrati, mandati i të cilit ka përfunduar pas zgjedhjeve të reja lokale në Kosovë. Rrjedhimisht, Kryetari i ri i Komunës së Kamenicës, ka parashtruar kërkesë për tërheqje të kërkesës KO145/21, duke theksuar se “*nuk ka asnjë interes juridik për vlerësimin e kushtetutshmërisë*”, së Vendimit të kontestuar, duke mos sqaruar më tutje kërkesën e tij.

91. Megjithatë, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 35, pavarësisht kërkesës për tërheqjen e kërkesës së parashtruar, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën.
92. Gjykata ka parasysh që Vendimi i kontestuar është nxjerrë për një periudhë të caktuar dhe i njëjti ka prodhuar efekte në të kaluarën, përkatësisht sipas sqarimit të MASHTI-it, nga 4 maji 2021 deri me 31 korrik 2021. Gjykata i rikujton argumentet e parashtruesit të kërkesës i cili lidhur me efektet juridike të Vendimit të kontestuar, konsideron se përpos faktit që MASHTI ka cenuar kompetencat që komunës i takojnë, ekziston dëmi i pa-riparueshëm sepse 441 nxënës nuk do pajisen me diploma përkatëse, për shkak të Vendimit të kontestuar, dhe sipas tij ekziston rreziku që MASHTI të vazhdojë të ndërhyjë në mënyrë të kundërligjshme në kompetencat e parashtruesit të kërkesës.
93. Megjithatë, Gjykata duke pasur parasysh natyrën e kontestit dhe rëndësinë e respektimit të parimeve të vetëqeverisjes lokale, siç parashihen me Kushtetutë e Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale me rastin e paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës, konsideron se është në interes publik deklarimi i Gjykatës, sepse (i) një deklarim i tillë ka një qëllim, dhe ai është qartësimi i pretendimeve për shkelje të parimeve kushtetuese lidhur me vetëqeverisjen lokale, në kontekst të cenimit të përgjegjësive komunale nga ana e nivelit qendror, dhe (ii) një deklarim i tillë do parandalonte që një situatë e tillë të ndodhë në të ardhmen.
94. Rrjedhimisht, Gjykata, vendosë që kërkesën e kryetarit z. Kadri Rahimaj, të refuzojë, dhe të vazhdojë me shqyrtimin dhe vendosjen e rastit, bazuar në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara, dhe në dokumentet që i janë dorëzuar Gjykatës.

(ii) Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

95. Nisur nga vlerësimi i lartcekur, Gjykata do vazhdojë, me vlerësimin e kritereve të pranueshmërisë, të cilat përcaktojnë shprehimisht që (i) Komuna duhet të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një akti të Qeverisë; dhe (ii) Komuna duhet të shpjegojë se ligji ose akti i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e saj. Bazuar në Ligj dhe Rregulloren e punës, ky ligj ose akt duhet të kontestohet në Gjykatë brenda një (1) viti nga hyrja e tij në fuqi.

(a) Pala e autorizuar

96. Lidhur me kushtin e parë, përkatësisht për palën e cila ka të drejtë në parashtrimin e kërkesës Gjykata vëren se Komuna e Kamenicës [parashtruesi i kërkesës] është e autorizuar të paraqesë kërkesë kushtetuese pranë Gjykatës, bazuar në nenin 113 paragrafi 4 i Kushtetutës.
97. Në këtë pikë, Gjykata rikujton se kërkesën e ka parashtruar në kohën sa ka qenë kryetar z. Qëndron Kastrati, ndërsa kryetari i ri z. Kadri Rahimaj, ka kërkuar

tërheqjen e lëndës. Mirëpo, Gjykata konsideron se kërkesa KO145/21 nuk është e lidhur me një funksion publik të ushtruar në emër të një komune, në rastin konkret, të kryetarëve përkatës, por është e lidhur me komunën si palë e autorizuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës. Rrjedhimisht Gjykata konstaton që kërkesa e tillë vazhdon të ekzistojë dhe t'i atribuohet Komunës, si palë e autorizuar që e ka parashtruar atë, pavarësisht ndërrimit të përfaqësuesit të komunës.

(b) Akti i kontestuar

98. Lidhur me kushtin e dytë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, konteston Vendimin nr.01B/24, të 23 prillit 2021 të MASHTI-it. Nëse e njëjta mund të konsiderohet “Akt i Qeverisë”, Gjykata do e vlerësojë në vijim.
99. Gjykata rikujton se në praktikën e saj, ka trajtuar raste të cilat është kërkuar vlerësim i kushtetutshmërisë së akteve të ndryshme të Qeverisë. Varësisht nga rasti konkret, Gjykata ka vlerësuar nëse akti i tillë, mund të hyjnë kategorinë e akteve që i përcakton juridiksioni i Gjykatës sipas nenit 113 të Kushtetutës. Në këtë kontekst rikujton që në rastin KO73/16, ka shpallur të pranueshme vlerësimin e kushtetutshmërisë së një “Qarkoreje Administrative”, përkatësisht Qarkores Administrative nr. 01/2016 të 21 janarit 2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike, duke marrë parasysh efektin e saj (shih rastin KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21 janar 2016, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016, paragrafët 46, 56 e 58).
100. Kjo praktikë gjyqësore është konfirmuar edhe në Aktgjykimin KO54/20, përmes të cilit Gjykata, duke e shpallur të pranueshme kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të 23 marsit 2020 të Kryeministrit, kishte theksuar se (i) në përcaktimin nëse kontestohet një “dekret” i Kryeministrit në kuptim të nën paragrafit 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, “*nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij*” (shih Aktgjykimin KO54/20, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 161); dhe (ii) nëse Gjykata do të fokusohet vetëm në emërtimin formal të akteve të kontestuara, përkatësisht “dekret të Kryeministrit” apo edhe “rregullore të Qeverisë”, vendimmarrja e Qeverisë, do të ngelej jashtë kontrollit kushtetues, vetëm duke u bazuar në emërtimin të cilin të njëjtat kanë vendosur t’ia përcaktojnë aktit përkatës. (Shih në këtë kontekst, paragrafët 162-163 të Aktgjykimit KO54/20, shih gjithashtu *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KO 61/20, parashtrues i kërkesës, *Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e

sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, Aktgjykim i 1 majit 2020, paragrafi 96).

101. Në rastin KO61/21, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 1 të nenit 92 të Kushtetutës, Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Të njëjtit, bazuar në paragrafin 2 të po të njëjtit nen, ushtrojnë pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se edhe vendimet e Ministrave, i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj, dhe bazuar në vlerësimin e Gjykatës përkitazi me efektin e tyre dhe nëse të njëjtat ngrisin “çështje të rëndësishme kushtetuese”. (shih rastin KO61/21, parashtrues i kërkesës, *Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 99; dhe shih rastin e Gjykatës KO139/18, me parashtrues *Komuna Skënderaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektorale nr. 05-3815, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 shtatorit 2020, paragrafi 42 dhe referencat e tjera të përdorura aty).
102. Gjykata rikujton argumentet e MASHTI-it, e cila thekson se Vendimi i Qeverisë shërben si shkallë e dytë për vendimet e Ministrisë [MASHTI] sipas nenit 128 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar ankesë ndaj aktit administrativ [vendimit të kontestuar], sipas afatit ligjor të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 127 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton afatin prej 30 ditësh për paraqitjen e ankesës nga pala. Rrjedhimisht, MASHTI konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për të atakuar me mjete juridike aktin administrativ.
103. Megjithatë, Gjykata rikujton se paragrafi 4 i nenit 113 të Kushtetutës nuk kërkon shterjen e mjeteve juridike lidhur me parashtrimin e kërkesave për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Kushtetuta në paragrafin 4 të nenit 113 të saj, përcakton dy kushte kryesore, jo-kumulative, kur pretendohen se me ligjin apo aktin përkatës të Qeverisë janë cenuar (i) përgjegjësitë komunale; ose (ii) janë zvogëluar të hyrat e komunës. Pra, juridiksioni i përcaktuar në nenin 113 paragrafi 4 është tregues që ligjet apo vendimet të cilat janë objekt i shqyrtimit duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me përgjegjësitë, përkatësisht kompetencat e komunave ose të hyrat financiare të komunave, nga Gjykata Kushtetuese, si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës.
104. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës konteston shprehimisht një Vendim të nxjerrë nga një Ministri, përkatësisht MASHTI, duke pretenduar se i njëjti cenon përgjegjësitë e komunës, përkatësisht, kompetencat e garantuara me Kushtetutë.
105. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Vendimi nr.01B/21 i 23 prillit 2021 i MASHTI-it, konsiderohet “Akt i Qeverisë”, sipas nenit 113 paragrafi 4 të Kushtetutës dhe me nenin 40 të Ligjit.

(c) Afati i Dorëzimit

106. Vendimi nr.01B/24 i 23 prillit 2021, është kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë më 12 gusht 2021, brenda afatit 1 (një) vjetor siç përcaktohet me nenin 113 paragrafin 4 të Kushtetutës, me nenin 41 të Ligjit dhe paragrafin 3 të nenit 73 të Rregullores së Punës.

(d) Përmbushja e kritereve tjera

107. Gjykata më lart, konstatoi se kërkesa (i) është dorëzuar nga pala e autorizuar; (ii) vendimi i kontestuar, konsiderohet “Akt i Qeverisë”; dhe ky i fundit (iii) është dorëzuar brenda afatit.
108. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur (i) informatat relevante në lidhje me vendimin e kontestuar; (ii) dispozitat specifike të Kushtetutës të cilat pretendohet se janë shkelur; dhe (iii) përgjegjësitë e komunës që janë të prekura nga Vendimi i kontestuar, në pajtim me pikën (a) (b) dhe (c) të paragrafit 2 të rregullit 73 të Rregullores së Punës.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

109. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me vendimet për riorganizimin e procesit të mësimit në disa shkolla fillore nga Komuna e Kamenicës [parashtruesi i kërkesës], si pjesë e reformës së arsimit në këtë të fundit. Kjo reformë ishte realizuar përmes caktimit të vijueshmërisë së mësimit nga disa shkolla përkatëse, në lokacione tjera. Lidhur me kompetencën për riorganizim, MASHTI dhe parashtruesi i kërkesës, kishin marrë edhe një Opinion ligjor nga MAPL, i cili kishte konstatuar që komunat kanë të drejtë në vendimmarrje sa i përket arsimit publik fillor dhe të mesëm dhe në kuadër të kësaj kompetence mund të riorganizojnë arsimin publik fillor dhe të mesëm.
110. Megjithatë, nga raportet e inspektimeve të arsimit kishte rezultuar që disa fëmijë nuk kishin vijuar procesin mësimor, përkatësisht “*nuk e kanë ndjekur procesin mësimor përgjatë një (1) viti shkollor në katër institucione arsimore dhe dy (2) vite në institucionin arsimor në Busavatë*”, sepse prindërit e tyre nuk ishin pajtuar me riorganizimin. MASHTI kishte formuar një komision *ad-hoc*, për vlerësimin e situatës, dhe ky i fundit, kishte rekomanduar ndërmarrjen e veprimeve nga ana e MASHTI, parashtruesi i kërkesës [Komuna e Kamenicës] dhe prindërit për të adresuar humbjet në mësim. Rrjedhimisht, MASHTI kishte nxjerrë Vendimin nr.01B/24 të 23 prillit 2021 “*Për organizimin e mësimit alternativ të përsheptuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës*”, përmes të cilit kishte organizuar mësimin alternativ të përsheptuar në pesë (5) shkolla dhe paralele përkatëse në Komunën e Kamenicës, të cilat, ishin riorganizuar tashmë përmes vendimeve të parashtruesit të kërkesës.

111. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Komuna e Kamenicës para Gjykatës e konteston Vendimin e lartcekur të MASHT-it, me arsyetimin se i njëjti ndërhyrës në kompetencat e Komunës, kompetenca këto të cilat ai i konsideron të garantuara me nenet 12 [Pushteti Lokal], 123 [Parimet e Përgjithshme], 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 2 (Baza Kushtetuese dhe Ligjore e Vetëqeverisjes Lokale) e 4 (Fushëveprimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
112. Parashtruesi i kërkesës, konkretisht thekson se Vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 12 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 17 paragrafi (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sepse bazuar në këtë dispozitë komuna, ka kompetencë ekskluzive të ofrojë arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore. Parashtruesi i kërkesës konsideron se MASHTI: (i) nuk ka kompetencë të organizojë mësim alternativ ose plotësues dhe vetëm mund të kërkojë nga komuna që të organizojë këtë lloj mësimi; dhe (ii) nuk ka kompetencë për të caktuar lokacionet e institucioneve arsimore e as të obligojë komunën që të mbajë mësim alternativ në institucione arsimore të palicencuara dhe të cilat për nevojat e ligjit ato nuk ekzistojnë edhe më tutje si objekte shkollore. Bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI nuk ka përfillur këtë dispozitë ngase punësimi i mësimdhënësve është e kompetencë ekskluzive e komunës, sepse me punësimin e personave që nuk kanë kontratë me komunën, MASHTI ka tejkaluar autorizimet e saj dhe ka hyrë në përgjegjësitë e komunës. Parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI ka rol monitorues dhe jo vendimarrës dhe këtë argument e mbështetë në nenin 5 dhe nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Për më shumë, parashtruesi i kërkesës thekson se me Vendimin e kontestuar janë shkelur dispozitat e Ligjit për Arsimin në Komuna sepse neni 3, pika l) i të njëjtit, ka paraparë që përgjegjësi e Ministrisë është inspektimi i procesit arsimor.
113. Në anën tjetër MASHTI, në argumentet e tyre theksojnë se në asnjë mënyrë nuk ka cenuar përgjegjësitë komunale dhe nuk ka zvogëluar të hyrat komunale. MASHTI konsideron se këto kompetenca sipas Kushtetutës janë përgjegjësi shtetërore dhe jo komunale e që me asnjë veprim të saj MASHTI nuk ka ndërhyrë në kompetencat e parashtruesit të kërkesës kur ka lejuar qasje në shkolla sepse, sipas pretendimeve, kjo e fundit është pjesë thelbësore e së drejtës në edukim. MASHTI po ashtu konsideron se pa paragjykuar kompetencat e Komunës [parashtruesit të kërkesës] në kuptim të sigurimit të zhvillimit të arsimit në këtë Komunë, konsideron që është obligim i shtetit, në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që të sigurojë implementimin e garantimit të së drejtës në edukim, duke ofruar edhe, si pjese integrale e kësaj të drejte, qasje në institucionet e edukimit të ndërtuara dhe të autorizuara për po këtë qellim.
114. Gjykata poashtu rikujton se lidhur me këtë çështje është zhvilluar edhe një kontest i konfliktit administrativ, ku disa prindër banues të Komunës së Kamenicës kanë ngritur procedura për pezullimin e vendimit përkatës të parashtruesit të kërkesës.

Këto procedura nuk kontestohen dhe rrjedhimisht nuk janë objekt shqyrtimi para Gjykatës.

115. Para analizimit të çështjeve thelbësore që ngërthen kërkesa e parashtruesve të kërkesës, përkatësisht nëse përmes Vendimit të kontestuar, MASHTI ka cenuar përgjegjësitë komunale dhe ka ndërhyrë në kompetencat vetanake të Komunës të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet e aplikueshme, Gjykata e konsideron të nevojshme të sqarojë çështjet si në vijim: (i) efektet financiare të vendimit të kontestuar; (ii) obligimin e shtetit për sigurimin e zhvillimit të arsimit; dhe (iii) procedurën gjyqësore të zhvilluar nga prindërit për pezullimin e vendimit përkatës të parashtruesit të kërkesës.

(i) lidhur me efektet financiare të vendimit të kontestuar

116. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Vendimi i kontestuar i MASHTI-it ka rezultuar në zvogëlimin e të hyrave komunale. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht, i referohet çështjes së kompensimit të mësimdhënësve të angazhuar nga MASHTI, dhe të cilët nuk figurojnë në listën e pagave në Komunë. Lidhur, me këtë pretendim MASHTI, është përgjigjur duke theksuar se përmes Vendimit të kontestuar nuk i ngarkohet asnjë shpenzim shtesë parashtruesit të kërkesës dhe i njëjti nuk ka sjellë asnjë dëshmi që janë krijuar shpenzime shtesë edhe pasi vendimi është zbatuar. MASHTI, kishte argumentuar që (i) asnjë nga pikat e vendimit të kontestuar nuk krijohen shpenzime shtesë për parashtruesin e kërkesës; dhe (ii) asnjë nga mësimdhënësit nuk ka kërkuar kompensim shtesë në angazhimin e tyre.
117. Në këtë kontekst Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në përgjigjen e tij pas nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, ndaj MASHTI të 27 prillit 2021, kishte theksuar që Vendimi i kontestuar krijon kosto buxhetore për Komunën dhe kërkon nga MASHTI t'i mbulojë ato dhe t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit/transportit të nxënësve dhe pagesën e orëve shtesë të mësimdhënësve.
118. Gjykata poashtu rikujton se MASHTI më 28 prill 2021, përmes postës elektronike iu ishte përgjigjur parashtruesit të kërkesës, lidhur me shkresën e tij të 27 prillit 2021 ku kërkon nga parashtruesi i kërkesës raport me dëshmitë e punës sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me pagesat e mësimdhënësve *“të cilët janë angazhuar mbi normën e përcaktuar me ligj”*. MASHTI poashtu kishte theksuar se meqenëse nxënësit ndjekin mësimin në shkollat më afër tyre, atëherë nuk krijohen shpenzime shtesë lidhur me transportin e atyre fëmijëve, sepse ai nuk është i nevojshëm.
119. Gjithashtu parashtruesi i kërkesës në komentet e tij të dërguara pranë Gjykatës, kishte theksuar se ka pasur zvogëlim të hyrave në mënyrë direkte *“për shkak se përveç që i janë cenuar përgjegjësitë, të njëjtës i janë shtuar obligime financiare që ndër të tjera janë: Energjia Elektrike si kosto shtesë për objekte të përcaktuara nga vetë Ministria dhe jo nga parashtruesi i kërkesës”*.

120. Lidhur me efektet financiare të Vendimit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës, thekson sipas pretendimit, se MASHTI ka angazhuar mësimdhënës të cilët nuk janë të punësuar pranë parashtruesit të kërkesës, e që sipas parashtruesit kjo vërtetohet me raportin sipas provës nr. 12 të kërkesës.
121. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përkundër që ka pretenduar “shpenzime shtesë”, dhe ka sjellë një dokument ku konstatohet lidhur me 5 persona që kanë dhënë mësim pa asnjë kontratë të lëshuar nga DKA, në një shkollë në Busavatë, megjithatë parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar dhe mbështetur pohimet e tij lidhur me shpenzimet e mundshme të krijuara nga Vendimi i kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata e konsideron këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, të pabazuar.

(ii) lidhur me argumentin e MASHTI për obligimin e shtetit për sigurimin e zhvillimit të arsimit

122. MASHTI, në argumentet e saj, bazohet në pohimet se këto kompetenca sipas Kushtetutës janë përgjegjësi shtetërore dhe jo komunale dhe është obligim i shtetit, në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të sigurojë implementimin e garantimit të së drejtës në edukim. MASHTI, pohon se bazuar në nenin 22 dhe 53 të Kushtetutës, dhe duke vënë theks tek neni 2 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së lidhur me të drejtën në edukim, thekson se e njëjta garanton të drejtën e çdo individi në edukim, por e drejtë kjo që implikon edhe përgjegjësi të caktuara për shtetin, që të garantohet një drejtë e tillë. MASHTI i referohet edhe rasteve të GJEDNJ-së lidhur me të drejtën për edukim. MAPL mbështetë këtë argument duke theksuar se Vendimi i kontestuar nuk mund të konsiderohet se ka ndërhyrë në kompetencat vetanake të Komunes së Kamenicës [parashtruesit të kërkesës] për organizimin e procesit mësimor, por është në përputhje të plotë dhe në funksion të realizimit të të drejtave kushtetuese të fëmijëve për arsimim.
123. Në rastin konkret, MASHTI pohon se marrë parasysh protestimin e prindërve dhe mohimin e edukimit që iu bëhet fëmijëve në shenjë revolte, ka tentuar që me Vendimin e kontestuar, të kthejë të drejtën e fëmijëve për edukim të mirëfilltë.
124. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 47 [E Drejta për Arsimin] të Kushtetutës, përcakton që secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë, dhe shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike. Ndërsa paragrafi 2 i nenit 47 të Kushtetutës, thekson se institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj. Më tej, korniza ligjore, konkretisht neni 3 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar përcakton parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar, duke theksuar në paragrafin 1 të nenit 3 që asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim, ndërsa në paragrafin 2 përcakton që arsimit parauniversitar “është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë,” sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Për më tepër, paragrafi 3 i nenit 3 i Ligjit për

Arsimin Parauniversitar, përcakton që është obligim i përgjithshëm i MASHTI, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim.

125. Megjithatë, Gjykata thekson se kërkesa pranë Gjykatës, është ngritur sipas paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe juridiksioni i përcaktuar në këtë të fundit është tregues që ligjet apo vendimet të cilat janë objekt i shqyrtimit duhet t'i nënshtrohen vlerësimit nga Gjykata se a kanë cenuar përgjegjësitë komunale ose të hyrat financiare të komunave.

126. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do lëshohet në vlerësimin e të drejtës në arsim, ngase vlerëson që kjo çështje nuk lidhet me rrethanat e rastit konkret, porse objekt vlerësimi është raportit kushtetues mes qeverisjes qendrore dhe asaj lokale, përkatësisht nëse përmes Vendimit të kontestuar pushteti qendror ka ndërhyrë në kompetencat vetanake të Komunës përkatëse, siç janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet e aplikueshme.

(iii) lidhur me procedurën e iniciuar nga prindërit për pezullimin e vendimit përkatës të parashtruesit të kërkesës për riorganizimin e shkollave dhe çështjet tjera

127. Duke qenë të pakënaqur me vendimin e parashtruesit të kërkesës, për riorganizimin e shkollave në Komunën e Kamenicës, disa prindër, banues në Komunën e Kamenicës, kishin vendosur të parashtronin padi në procedurë të konfliktit administrativ, duke kërkuar anulimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përkatës të parashtruesit të kërkesës.

128. Gjykata Supreme, me dy vendime të saj duke shqyrtuar bazueshmërinë e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke arsyetuar se me asnjë provë bindëse nuk është arritur të dëshmohet se me ekzekutimin e vendimit përkatës atyre do iu shkaktohet dëm, i cili vështirë do riparohet dhe shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i shkaktonte dëm të riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-palës së interesuar. Pra, Gjykata Supreme kishte vlerësuar që në këtë çështje nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet ligjore ashtu siç parashihet me nenin 22 të Ligjit për Konflikt Administrative.

129. Marrë parasysh që objekt i kësaj kërkesë është ekskluzivisht vlerësimi i Vendimit nr.01/B24 i MASHTI-it, lidhur me cenimin e përgjegjësive komunale, kërkesë kjo e ngritur sipas nenit 113 paragrafi 4 i Kushtetutës, Gjykata në këtë rast nuk lëshohet në procedurën gjyqësore lidhur me vendimet e parashtruesit të kërkesës, sepse të njëjtat as nuk janë kontestuar dhe as nuk janë objekt shqyrtimi në rastin konkret.

130. Gjykata në fund, ka parasysh edhe argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-pajisjen me diploma përkatëse për shkak të organizimit të mësimi për 441 nxënësit nga MASHTI, ngase në bazë të vendimeve të parashtruesit të kërkesës ato pesë institucione arsimore të parapara me Vendimin e kontestuar nuk ekzistojnë më, dhe të njëjtat, nuk kanë *“as licencë, as mësimdhënës, as mirëmbajtje dhe asnjë kusht që procesi mësimor të zhvillohet.* Megjithatë, Gjykata thekson se është kufizuar vetëm në çështjen e vlerësimit të pretendimit për cenimin e përgjegjësiwe komunale, përkatësisht ndërhyrjes së MASHTI në kompetencat vetanake të parashtruesit të kërkesës.
131. Thënë këtë, në vijim, Gjykata do fokusohet vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar për të adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e përgjegjësiwe të këtij të fundit nga ana e MASHTI-it, përkatësisht ndërhyrjen në kompetencat vetanake të tij në organizimin e shkollimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, pretendime këto që do i trajtojë duke shtjelluar dhe analizuar (i) parimet e përgjithshme lidhur me Vetëqeverisjen Lokale sipas Kushtetutës; (ii) Statusin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, dhe parimet e përgjithshme të saj ; (iii) kornizën ligjore përkitazi me vetëqeverisjen lokale; (iv) parimet e elaboruara nga Komisioni i Venecias, dhe në fund, Gjykata (v) do të i zbatojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

I. Parimet e përgjithshme lidhur me Vetëqeverisjen Lokale sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe kornizës ligjore

(i) Parimet e përgjithshme sipas Kushtetutës

132. Gjykata vëren se Kushtetuta, në pjesën ku trajtohen Dispozitat Themelore të Kushtetutës, i ka akorduar rregullim të veçantë edhe pushtetit lokal. Bazuar në nenin 12 [Pushteti Lokal] të Kushtetutës, njësi territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat dhe organizimi dhe kompetencat e tyre rregullohen me ligj.
133. Megjithatë, në Kushtetutë, parashihet edhe një kapitull i veçantë, Kapitulli X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial], që përmban edhe dy nene, përkatësisht nenin 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 124 [Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Lokale]. Në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 123, Kushtetuta përcakton që e drejta për vetëqeverisje lokale garantohet dhe rregullohet me ligj dhe e njëjta ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese. Më tej, paragrafi 3 i nenit 123 të Kushtetutës përcakton që veprimtaria e organeve e vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës si dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.
134. Në fund, paragrafi 4 i nenit 123 të Kushtetutës përcakton parimet në bazë të cilave ushtrohet vetëqeverisja lokale duke përcaktuar kështu parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u

kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

135. Në anën tjetër, neni pasues, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 124 të Kushtetutës, përcakton që njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna dhe të njëjtat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
136. Gjykata vëren se në këtë mënyrë Kushtetuta përcakton modalitetet e qeverisjes lokale duke përcaktuar autoritetet publike dhe kompetencat e tyre, dhe duke vënë theks në ofrimin e shërbimeve publike. Gjykata vëren se parimet themelore që udhëhiqet qeverisja lokale janë parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që qëllimi i parimeve të efikasitetit dhe efektivitetit të qeverisjes lokale është i lidhur ngushtë me parimin e subsidiaritetit. Kjo nënkupton që vetëqeverisja lokale në disa sektorë të politikave publike është shumë më efikas dhe efektiv sesa nëse kompetenca për to do t'i besohej organeve qendrore.
137. Se çfarë kompetenca i ushtrojnë Komunat, të njëjtat i përcakton neni 124 i Kushtetutës, paragrafi 2 i cili përcakton se me ligj rregullohet themelimi, kufijtë, kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komunave. Paragrafi 3 i nenit 124 i Kushtetutës më tej thekson se Komunat në pajtim me ligjin kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara dhe autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit. Paragrafi 5 i nenit 124 të Kushtetutës, më tej, thekson që Komunat në pajtim me ligjin kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore.
138. Thënë këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 123 përcakton shprehimisht që veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Në anën tjetër, Kushtetuta përcakton se Republika e Kosovës merr parasysht dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues. Në vijim Gjykata do të elaborojë statusin e kësaj të fundit në rendin juridik të Republikës së Kosovës.
- (ii) *Lidhur me statusin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, dhe parimet e përgjithshme të saj*
139. Lidhur me statusin e instrumenteve ndërkombëtare, Gjykata fillimisht rikujton se në rastin e saj KI207/19, kishte trajtuar instrumentet ndërkombëtare që parashihen me nenin 22 të Kushtetutës dhe kishte theksuar që të njëjtat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, dhe kanë epërsi ndaj ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës,

(shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI207/19 parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020 paragrafët 105-111).

140. Në linjë me këtë, Gjykata rikujton se Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, nuk është instrument i përcaktuar me nenin 22 të Kushtetutës. Megjithatë, Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 123 kërkon që veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale të respektojë Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, ndërsa po i njëjti paragraf thekson se Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
141. Rrjedhimisht, në trajtimin e parimeve të vetëqeverisjen lokale, Gjykata do fokusohet edhe në aspektet kryesore të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, kartë kjo që i angazhon palët që të zbatojnë rregullat themelore që garantojnë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të autoriteteve lokale, si dhe parimet kryesore për funksionimin sa më të mirë të qeverisjes lokale. Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale në vetë hyrjen e saj përcakton se *“duke vlerësuar se autoritetet lokale janë një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik”* dhe *“e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta”*. Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcakton parimin e subsidiaritetit, parim ky që mundëson decentralizimin e pushtetit drejtë nivelit më të afërt me qytetarin.
142. Gjykata, në trajtimin dhe aplikimin e garancive të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, i referohet edhe raportit shpjegues të saj, i cili ka për qëllim sqarimin dhe lehtësimin e të kuptuarit të dispozitave të saj (shih, Raportin Shpjegues të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale të 15 tetorit 1985).
143. Në këtë linjë, Gjykata rikujton se neni 3 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, trajton konceptin e vetëqeverisjes lokale, duke përcaktuar në paragrafin 1 që vetëqeverisja lokale nënkupton të drejtën dhe mundësinë e autoriteteve lokale që brenda kufirit ligjor, të rregullojnë dhe menaxhojnë një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë lokale.
144. Më tutje, neni 4 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, sipas Raportit shpjegues, parashikon parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të bazohen përgjegjësitë e autoriteteve lokale dhe natyrën e kompetencave të tyre.
145. Fillimisht, neni 4 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcakton në paragrafin 1 që kompetencat dhe përgjegjësitë themelore të autoriteteve lokale do të përcaktohen me kushtetutë ose me ligj, ku sipas raportit shpjegues qëllimi i këtij neni konsiston në përcaktimin e sigurisë juridike sa i përket parashikueshmërisë së përgjegjësive të autoriteteve lokale në ligj. Paragrafi 2 i nenit 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale thekson se autoritetet lokale, brenda kufijve të ligjit, kanë diskrecionin e plotë për të ushtruar iniciativën e tyre në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre dhe nuk i është caktuar ndonjë autoriteti

tjetër, dhe sipas raportit shpjegues, ky paragraf ngërthen qëllimin që autoritetet lokale përveç përgjegjësive që u janë besuar me legjislacion, mund të shfaqen nevoja ose mundësi të tjera për veprim nga organet publike dhe në rastet ku këto fusha veprimi kanë implikime lokale është i rëndësishëm konceptimi i autoriteteve lokale si subjekte politike duke vepruar në të drejtën e tyre për të promovuar mirëqenien e përgjithshme të banorëve të tyre që ata kenë të drejtën për të ushtruar iniciativën e tyre në këto çështje. Megjithatë, sipas raportit shpjegues rregullat e përgjithshme sipas të cilave autoritetet lokale mund të veprojnë mund të përcaktohet me ligj.

146. Më tej, paragrafi 3 i nenit 4 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, thekson se përgjegjësitë publike duhet, në përgjithësi, të ushtrohen nga autoritetet më të afërta me qytetarët. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomizimit, dhe sipas raportit shpjegues ky paragraf përmban parimin e përgjithshëm që ushtrimi i përgjegjësive publike duhet të decentralizohet. Paragrafi 4 i nenit 4 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale tutje thekson se kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive, dhe kjo sipas raportit shpjegues bëhet me qëllim të shmangies së çdo tendence për pakësim të vazhdueshëm të përgjegjësive. Ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal përveç siç përcaktohet me ligj.
147. Paragrafi 5 i nenit 4 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, më tutje, përcakton se në rast se kompetencat i kalojnë një autoriteti qendror apo rajonal, autoritetet lokale duhet të gëzojnë, brenda mundësisë, lirinë që ushtrimin e tyre t'ia përshtatin kushteve lokale, ndërsa paragrafi 6 i nenit 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcakton që duhet t'u kërkohe mendimi autoriteteve lokale, brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet që u përkasin atyre drejtpërsëdrejti.
148. Në anën tjetër, neni 8 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, përcakton kontrollin administrativ të veprimeve të autoriteteve lokale, duke përcaktuar në paragrafin 1 që ky kontroll mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji dhe në paragrafin 2 që kontrolli i tillë, duhet të synojë sigurimin e respektimit të ligjshmërisë dhe të parimeve kushtetuese. Sipas raportit shpjegues, ky nen trajton mbikëqyrjen e aktiviteteve të autoriteteve lokale nga organe të niveleve të tjera qeverisëse, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni kërkon që duhet të jetë një bazë përkatëse ligjore për mbikëqyrje, ndërsa paragrafi 2 kërkon që mbikëqyrja administrative duhet të kufizohet në ligjshmërinë e veprimit të autoritetit lokal dhe jo përshtatshmërinë e tij, dhe sipas raportit shpjegues një përjashtim i veçantë, por jo i vetmi, bëhet në rastin e detyrave të deleguara, kur organi që i delegon kompetencat mund të përcaktojë të ushtrojë mbikëqyrjen mbi mënyrën sesi realizohen ato kompetenca nga autoritetet lokale.

149. Paragrafi 3 i nenit 8 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, parasheh që kontrolli administrativ i autoriteteve lokale duhet të ushtrohet duke respektuar proporcionalitetin mes rëndësisë së ndërhyrjes së autoritetit kontrollues dhe rëndësisë së interesave që ai kërkon të mbrojë, dhe sipas raportit shpjegues, parimi i proporcionalitetit në këtë rast nënkupton që organi kontrollues, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, është i detyruar të përdorë metodën që e prek më pak autonominë lokale, për të arritur rezultatet e dëshirueshme.

(iii) Korniza ligjore që rregullon kompetencat e Komunave në fushën e arsimit

150. Gjykata vëren se bazuar në Kushtetutë, (i) njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna; dhe (ii) me ligj rregullohet çështja e qeverisjes lokale, përkatësisht (a) themelimi, kufijtë, kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komunave duke përcaktuar shprehimisht që komunat kanë tri lloje të kompetencave: **a.** vetanake, **b.** të zgjeruara dhe **c.** të deleguara; dhe (b) vendosja, caktimi, mbledhja dhe shpenzimi i të hyrave të tyre.

151. Në mënyrë që komunat të ushtrojnë kompetencat e tyre siç përcaktohen me Kushtetutë dhe saktësohen me ligj, këto kompetenca përmbajnë transfer të kompetencave të fushës financiare, administrative e teknike. Për t'u jetësuar këto, nevojitet respektim i parimeve që sigurojnë vetëqeverisjen lokale. Me këtë rast, "vetëqeverisja lokale" në fakt nënkupton para se të gjithash ushtrimin autonom të kompetencave vetanake nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Autonomia e tillë nuk mund të zvogëlohet, mbikëqyret apo shpërfilllet nga asnjë autoritet qendror. Çfarëdo ndërhyrje që nuk është e parashikuar me Kushtetutë ose me ligj, në një autonomi të tillë cenon të drejtën e vetëqeverisjes lokale të komunave. Megjithëse, Kushtetuta e përcakton në mënyrë të saktë konceptin e kompetencave vetanake si një aspekt i lidhur me autonominë e komunave, dhe ajo udhëzon që kompetencat e tilla do të definohen saktësisht përmes një ligji përkatës. Udhëzimi në Kushtetutë, për nxjerrjen e një ligji që rregullon fushën e kompetencave të komunave, e në veçanti kompetencat vetanake, është një tregues që vlerësimi nëse është cenuar përgjegjësia e komunave, dhe shkelur parimi i kompetencave vetanake të komunave bëhet përmes vlerësimit të kompetencave të parashikuara specifikisht në ligjin apo ligjet përkatëse.

152. Në këtë linjë, Vetëqeverisja lokale, siç është elaboruar më lart, garantohej në Kushtetutë dhe në Kartën Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, dhe e njëjta përfshin kompetencën e njësisë lokale për të rregulluar dhe menaxhuar një pjesë të shërbimeve publike duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit. Këto kompetenca të parashikuara me Kushtetutë, mbi bazën e të cilave nxjerrën ligjet përkatëse përmes të cilave u kalohen ato kompetenca nga organet qendrore, janë kompetenca të tilla që përcaktojnë interesin më të mirë të komunitetit. Të njëjtat konsistojnë në kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin.

153. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata vëren se ligji kryesor që përcakton kompetencat e komunave është Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Një karakter i tillë i këtij ligji përbën bazë të rëndësishme mbi të cilën Gjykata duhet të vlerësoj llojet dhe natyrën e kompetencave që hyjnë në kategorinë e kompetencave “vetanake” të komunave në kuptim të paragrafit 3 të nenit 124 të Kushtetutës.
154. Andaj, në këtë aspekt, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ka përcaktuar që komunat, ndër të tjera, janë bartëse të kompetencave vetanake në disa nga fushat dhe si të tilla, këto kompetenca i ushtrojnë “të plota dhe ekskluzive” për sa i përket interesit lokal. Mirëpo, Gjykata rikujton se në rastin konkret, Ligji për Arsimin në Komunat dhe Ligjin për Arsimin Parauniversitar, janë poashtu ligje të cilat më tutje, rregullojnë aspekte të arsimit dhe shkollimit, duke përcaktuar kompetenca për komunat dhe për MASHTI-n. Rrjedhimisht në vijim dhe për aq as është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata do i analizojë këto kompetenca.
155. Ashtu siç është argumentuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe poashtu siç e vëren Gjykata, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 17 përcakton “kompetencat vetanake” të Komunave. Më konkretisht, dhe sa i përket çështjeve të arsimit, paragrafi 1 pika (h) e nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si kompetencë vetanake të komunave përfshin **“ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimi e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”**.
156. Më tutje, neni 3 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale i parasheh “Kompetencat vetanake”, dhe i përcakton si kompetenca që u jepen komunave me Kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin.
157. Ndërsa, vetë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 15 përcakton parimin e subsidiaritetit dhe thekson se *“Komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit,”* parim ky i përcaktuar edhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
158. Në anën tjetër, Ligji për Arsimin Parauniversitar, në nenin 7 përcakton kompetencat e Komunave, duke theksuar se kompetencat e komunave janë të rregulluara përmes (i) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, të 20 shkurtit 2008, dhe Ligjit për Arsim në Komuna, nr. 03/L-068, të 21 majit 2008; dhe (ii) kompetencave shtesë të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Rrjedhimisht, neni 7 i këtij ligji, thekson se Komunat mes tjerash, kanë përgjegjësitë shtesë si në vijim:
- “3.1. ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese;
3.2. mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore; [...]”*

159. Më tej, Ligji për Arsimin në Komunat, në paragrafin 1 të nenit 4, përcakton që Komunat kanë *“kompetenca të plota dhe ekskluzive”*, për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimeve dhe administratorëve. Më tej, në paragrafin 2 të nenit 4 të këtij ligji, theksohet se përveç kompetencave të referuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit për Arsimin në Komunat, thekson se komunave mund t’iu jepen kompetenca të zgjeruara në fushën e arsimit, ashtu si përshkruhet nga ky ligj dhe ligjet e tjera në fuqi.
160. Neni 5 i Ligjit për Arsimin në Komunat zbërthen më tej kompetencat e komunave duke përcaktuar që përpos kompetencave të parashikuara në nenin 4, përfshihen mes tjerash, edhe *“kompetencat e veçanta komunale”* si (i) ndërtimi i objekteve shkollore në pajtueshmëri me Kapitullin 3 të këtij ligji [Ligjit për Arsimin në Komunat] dhe me ligjet e tjera në fuqi; (ii) regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mos-diskriminimit sipas ligjit; dhe (iii) punësimi i mësimeve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë.
161. Më tej, siç u sqarua më lart, Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe Ligji për Arsimin në Komunat, parasheh edhe kompetencat e MASHTI-it. Duke qenë se në rastin konkret, pretendohet që MASHTI ka cenuar përgjegjësitë e Komunës së Kamenicës në fushën e arsimit, përkatësisht organizmit të shkollimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, Gjykata do analizojë edhe kompetencat e MASHTI-it në këtë kontekst.
162. Për sa i përket kompetencave të MASHTI-it, Gjykata vëren se të njëjtat sipas paragrafit 1 të nenit 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar përcaktojnë që MASHTI mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, mes tjerash, duke (i) zhvilluar politika dhe hartojë e zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit; (ii) të vendosë kritere dhe të menaxhojë një sistem të licencimit të mësimeve; dhe (iii) të dizajnojë dhe mbikëqyrë format efektive të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për t’u zbatuar nga komunat.
163. Më tej, paragrafi 6 i nenit 8 (Inspektimi i Arsimit) të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, përcakton udhëzimin se si të veprohet pas raportit të Inspektorit, duke përcaktuar në nënparagrafin 6.3 që, në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulimit, *“Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ”*.
164. Bazuar në paragrafin 8, 9 dhe 10 të nenit 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, MASHTI, *inter alia* (i) miraton standarde përkatëse; (ii) licencion dhe akrediton institucione; dhe (iii) vepron si organ i shkallës së dytë për vendimet e organeve të tjera arsimore dhe aftësuese.

165. Më tej, neni 3 i Ligjit për Arsimin në Komunat, përcakton përgjegjësitë e MASHTI-it, mes tjerash, që (i) të zhvillojë politika dhe të hartoj e implementoj legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencën në Kosovë; (ii) të krijojë dhe menaxhojë një sistem të përgjithshëm të certifikimit për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë; (iii) të përmirësojë cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin arsimor në të gjitha nivelet; dhe (iv) të inspektojë arsimin.
166. Prandaj, nga të lartcekurat, Gjykata konstaton që në kuptim të vendimit të kontestuar, kompetenca e komunave e parashikuar në nenin 17 (h) në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale për *“ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimi e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”*, hyn në kategorinë e kompetencave “vetanake” në të cilat udhëzon detyrueshëm paragrafi 3 i nenit 124 të Kushtetutës dhe përbën një element thelbësor të asaj që neni 12 i Kushtetutës e cilëson si “vetëqeverisjes lokale”. Prandaj, kompetenca e komunave për organizimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm përbën njërin nga këto kompetenca që sipas Kushtetutës hyjnë në kuadër të detyrimeve të paragrafit 3 të nenit 124 të Kushtetutës, dhe që në rastin konkret, e zbaton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, i cili zbaton këtë normë kushtetuese në mënyrë të drejtë. Kjo kompetencë, që Ligji për Vetëqeverisje Lokale, e quan “kompetencë vetanake”, si e tillë në nenin 3 të këtij të fundit, përcakton si kompetencë për të cilën komuna është plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin. Gjykata rikujton në këtë pikë se edhe Ligji për Arsimin në Komunat, në paragrafin 1 të nenit 4 të tij, përcakton që Komunat kanë *“kompetenca të plota dhe ekskluzive”*, në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve. Për më tepër, neni 5 i Ligjit për Arsimin në Komunat, ka përcaktuar më tej kompetencat e komunave duke përcaktuar që përpos kompetencave të parashikuara në nenin 4 të Ligjit mbi Arsimin në Komunat, përfshihen edhe *“kompetencat e veçanta komunale”*, e që për qëllime të rrethanave të rastit konkret, janë të tilla, por duke mos u kufizuar në ndërtimin e objekteve shkollore, punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave, regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore parashkollore, pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin.
167. Ndërsa, bazuar në ligjet e mësipërme, MASHTI, ka kompetenca sipas paragrafit 1 të nenit 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar për të mbajtur përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, përgjegjësi kjo e cila sigurohet duke zhvilluar politika dhe legjislacion dhe kriteret për licencim të mësimdhënësve. MASHTI, një ndër kompetencat kryesore, ka edhe inspektimin e arsimit, ku në paragrafin 6 të nenit 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, përcaktohet që MASHT mund të marrë veprime përkatëse, përfshirë sipas nënparagrafit 6.3 të paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, përkatësisht kërkimin e zbatimit të mësimin

shtesë ose alternativ. Ndërsa sipas nenit 3 të Ligjit për Arsimin në Komunitet, përcaktohen përgjegjësitë e MASHTI-it, në zhvillimin e politikave dhe hartimin e implementimit të legjislacionit për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencën në Kosovë, si dhe krijimin dhe menaxhimin e një sistemi të përgjithshëm të certifikimit për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë. Poashtu në këtë nen të fundit, hyn dhe përmirësimi i cilësisë, përshtatshmërisë dhe efikasitetit arsimor në të gjitha nivelet si dhe inspektimin e arsimit.

(iv) Parime të përgjithshme të trajtuara nga Komisioni i Venecias

168. Komisioni i Venecias ka trajtuar mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale. Në Opinionet e tij, sa u përket aspekteve të vetëqeverisjes lokale, Komisioni i Venecias ka analizuar, mes tjerash, draftin final të Kushtetutës së Republikës së Tunizisë (shih Opinionin CDL-AD (2013) 032), Draft Ligjin për ndryshimin e Kushtetutës së Ukrainës (shih Opinionin CDL-AD (2014) 037), dhe Draft Ligjin Kushtetues për ndryshimet dhe amendamentet në Kushtetutën e Gjeorgjisë (shih Opinionin CDL-AD (2010) 008).
169. Në këtë aspekt, Komisioni Venecias *inter alia* ka trajtuar çështje si (i) garancitë kushtetuese për vetëqeverisje lokale; dhe (ii) fushëveprimin e vetëqeverisjes lokale dhe kompetencat.
170. Sa i përket pikës (i) lidhur me garancitë kushtetuese për vetëqeverisje lokale Komisioni i Venecias trajton parimin e vetëqeverisjes lokale (decentralizimit), duke u bazuar në tri parime kryesore: (a) parimi i decentralizimit; (b) parimi i subsidiaritetit; dhe (c) përshtatshmëria ndërmjet kompetencave dhe burimeve financiare.

i) Lidhur me garancitë kushtetuese për vetëqeverisje lokale

(a) Parimi i decentralizimit

171. Në lidhje me këtë parim, Komisioni i Venecias në Opinionin e tij të Dytë CDL-AD (2013) 032, të draftit final të Kushtetutës së Republikës së Tunizisë, ndër të tjera kishte theksuar se:

“13. Kushtetuta duhet të përfshijë jo vetëm marrëveshjet e organizimit të fuqisë qendrore të shtetit dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve, por edhe ekzistenca dhe funksionimi i institucioneve të vetëqeverisjes lokale, të cilat shfaqin një rol thelbësor në përhapjen e lirisë dhe demokracisë në shoqëri përmes rolit të tyre ndërmjetësues midis Shtetit dhe qytetarëve.”

[...]

“48. Përderisa shtrirja dhe forma e vetëqeverisjes lihen sipas standardeve ndërkombëtare e veçanërisht Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, në diskrecion të shteteve, disa parime janë thelbësore: që përgjegjësitë publike të ushtrohen, sipas preferencës, nga ato autoritete që janë më të afërta me

qytetarët; se delegimi i kompetencave duhet të shoqërohet me ndarjen e burimeve të mjaftueshme; dhe se mbikëqyrja administrative e aktiviteteve të autoriteteve lokale duhet të kufizohet.”

(b) Parimi i subsidiaritetit

172. Lidhur me parimin e dytë, në Opinionin e tij të Dytë CDL-AD (2014) 037, lidhur me Projektligjin për ndryshimin e Kushtetutës së Ukrainës, Komisioni i Venecias ndër të tjera kishte theksuar:

“180. Neni i ndryshuar 120 (1) mbështetet në nenin aktual 120, i cili përcakton parimet e decentralizimit, autonomisë lokale dhe decentralizimit të shërbimeve publike. Ajo shton se decentralizimi duhet të zbatohet sipas parimit të subsidiaritetit dhe që transferimi i kompetencës duhet të shoqërohet me burime përkatëse financiare [...]”

(c) Përshtatshmëria ndërmjet kompetencave dhe burimeve financiare

173. Parimi tretë i Komisionit të Venecias, lidhur me përshtatshmërinë e kompetencave dhe burimeve financiare përfshinë (a) Parimin e mbështetjes financiare të shtetit për vetëqeverisjen lokale; dhe (b) Parimin e autonomisë financiare.
174. Në lidhje me këtë parim, Komisioni i Venecias në Opinionin për Draft Ligjin Kushtetues për ndryshimet dhe amendamentet në Kushtetutën e Gjeorgjisë ka theksuar obligimin e pushtetit shtetëror për mbulim financiar kundrejt funksioneve të deleguara te organet e pushtetit lokal. Komisioni i Venecias ishte shprehur se: *“Pushteti shtetëror do të ushtrohet në nivel lokal nga autoritetet shtetërore, derisa krejt pushteti i vetëqeverisjes lokale do të ushtrohet nga organet lokale të vetëqeverisjes, përveç në rastet kur obligime specifike shtetërore i delegohen organeve të vetëqeverisjes lokale dhe që ushtrohen në emër të shtetit. Kjo dispozitë duhet ta stimulojë zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha nivelet. Po ashtu është parashikuar se kostoja e funksioneve të deleguara duhet të mbulohet me bartje të buxhetit ose me bartje të burimeve ose të pronës. Megjithatë, kjo dispozitë nuk garanton që shuma e burimeve të ndara do të mbulojë koston e funksioneve të deleguara. Prandaj, rekomandohet që dispozita të modifikohet dhe të ofrojë shprehimisht për kompensim të plotë të barrës financiare që rezulton nga delegimi, duke iu shmangur kështu rrezikut se detyrat shtetërore janë deleguar kryesisht për ta zbutur rëndimin e buxhetit të shtetit.”* (shih CDL-AD (2010) 008, Opinion për Draft Ligjin Kushtetues për ndryshimet dhe amendamentet në Kushtetutën e Gjeorgjisë (Kapitulli VII – Vetëqeverisja Lokale). Lidhur me parimin e tretë të Vetëqeverisjes lokale, Komisioni i Venecias qëndrimin e tij në të njëjtën linjë e kishte mbështetur edhe me opinione tjera (CDL-AD (2015) 028, Opinioni lidhur me Amendamentet e Kushtetutës së Ukrainës, lidhur me strukturën Territoriale dhe Administrimin Lokal).
175. Gjykata vëren se parimet e lartpërmendura janë të përshkruara përgjithësisht në natyrën e kontrollit që e ushtron Gjykata në bazë të Nenit 113 paragrafi 4.

Rrjedhimisht, të tilla parime përbëjnë edhe detyrime për respektim të tyre nga organet qendrore të Republikës së Kosovës.

ii) Lidhur me fushëveprimin e vetëqeverisjes lokale dhe kompetencat

176. Komisioni i Venecias ka trajtuar edhe çështjen e fushëveprimit të vetëqeverisjes lokale dhe kompetencat, duke i ndarë ato në (a) kompetenca vetanake/të deleguara; (b) kompetenca të de-koncentruara/decentralizuara.

(a) kompetenca vetanake/të deleguara

177. Në këtë aspekt, sa i përket kompetencave Komisioni Venecias kishte përcaktuar në Opinionin CDL-AD (2015) 028 lidhur me Amendamentet në Kushtetutën e Ukrainës që një tipar thelbësor i rregullimit të vetëqeverisjes lokale është identifikimi i funksioneve bazë (funksioneve “vetanake” për dallim nga kompetencat e deleguara) dhe një zgjidhje do të konsistonte në përcaktimin në nivel kushtetues të “kompetencave vetanake” të njërive të vetëqeverisjes lokale e cila do parandalonte qeveritë që të heqin kompetencat nga qeverisja lokale, në ata nuk disponojnë shumicën e kualifikuar. Një përmirësim tjetër sipas Komisionit të Venecias është që Kushtetuta të përcaktojë që “*parimet themelore të kompetencave të vetëqeverisjes lokale përcaktohen me ligj organik*”.

178. Më tej, sa i përket delegimit Komisioni Venecias në Opinionin CDL-AD (2009) 024 lidhur me draft ligjin për amendamentimin e Kushtetutës së Ukrainës thekson se mund të nënkuptojë transferimin e përhershëm të një pushteti ose veprimtarie shtetërore te pushteti lokal me qëllim që të bëhet një “pushtet i vetë” i qeverisjes lokale. Është zgjerim i decentralizimit dhe i pushtetit të vetëqeverisjes lokale.

(b) kompetenca të de-koncentruara/ decentralizuara

179. Komisioni Venecias në Opinionin CDL-AD (2009) 024 lidhur me draft ligjin për amendamentimin e Kushtetutës së Ukrainës ka theksuar se dekoncentrimi është krejt i ndryshëm nga decentralizimi. “Dekoncentrimi” varet nga ekzistenca e qarqeve territoriale në të cilat shteti është i pranishëm në formën e shërbimeve të tij, ndërsa decentralizimi mbështetet në praninë e bashkësive territoriale, organet e të cilave zgjidhen dhe ushtrojnë disa kompetenca në emër të tyre [...]”

Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

180. Gjykata rikujton thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht shkeljen e nenit 12 [Pushteti Lokal], nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 2 (Baza Kushtetuese dhe Ligjore e Vetëqeverisjes Lokale) dhe nenin 4 (Fushëveprimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht kompetencat vetanake, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, ndër të tjera, përkitazi me ofrimin e arsimit

publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit. Më tej, parashtruesi i kërkesës, argumentet e tij lidhur me cenimin e përgjegjësive të tij, përkatësisht ndërhyrjen e MASHTI-it në kompetencat e tij, i ndërlidhë me atë se MASHTI nuk ka kompetencë të organizojë mësim alternativ ose plotësues; dhe (ii) nuk ka kompetencë për të caktuar lokacionet e institucioneve arsimore e as të obligojë komunën që të mbajë mësim alternativ në institucione arsimore të palicencuara dhe të cilat për nevojat e ligjit ato nuk ekzistojnë edhe tutje si objekte shkollore. Parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI nuk është organ i cili mund të lëshojë certifikata dhe dëftesa për nxënësit që kanë ndjekur procesin arsimor, ndërsa komuna, në rrethanat e rastit, nuk mund ta bëjë këtë sepse nuk është organizatore. Në këtë pikë, parashtruesi i kërkesës thekson se MASHTI ka *“rol monitorues dhe jo vendimmarrës”* dhe këtë argument e mbështetë në nenin 5 dhe nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Me këtë rast, parashtruesi i kërkesës nuk i konteston kompetencat e MASHTI-it lidhur me nenin 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, mirëpo konsideron se nuk parashihet me këtë nen *“organizimi”* i mësimin alternativ apo shtesë.

181. MASHTI në anën tjetër, konsideron se këto kompetenca sipas Kushtetutës janë përgjegjësi shtetërore dhe jo komunale e që me asnjë veprim të saj MASHTI nuk ka ndërhyrë në kompetencat e parashtruesit të kërkesës *“kur ka lejuar qasje në shkolla”* sepse kjo e fundit është pjesë thelbësore e së drejtës në edukim. MASHTI po ashtu konsideron se pa paragjykuar kompetencat e Komunës [parashtruesit të kërkesës] në kuptim të sigurimit të zhvillimit të arsimit në këtë Komunë, konsideron që është obligim i shtetit, në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që të sigurojë implementimin e garantimit të së drejtës në edukim, duke ofruar edhe, si pjesë integrale e kësaj të drejte, qasje në institucionet e edukimit të ndërtuara dhe të autorizuar për po këtë qëllim. MASHTI konsideron se preambula e vendimit thekson se vendimi i kontestuar bazohet në kompetencat e saj sipas Rregullores së Qeverisë 02/2021, neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, shtojca I, duke argumentuar kështu se nuk ka ndërhyrë në kompetencat e Komunës së Kamenicës (parashtruesit të kërkesës).
182. Gjykata vëren se para se të nxjerrët Vendimi i kontestuar, janë ndërmarrë veprimet konkrete nga parashtruesi i kërkesës për riorganizimin e shkollave në Komunë, duke marrë parasysh numrin e vogël të nxënësve të disa shkolla dhe kryesisht duke përcaktuar se nxënësit e shkollës përkatëse vijnë në shkollën tjetër përkatëse. Këto vendime nga Kryetari i Komunës së Kamenicës [parashtruesi i kërkesës] janë nxjerrë duke u bazuar në paragrafin 4.1 të nenit 4 të Ligjit për Arsimin në Komunat dhe paragrafin 9 të nenit 14 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, si dhe bazën nënligjore Udhëzimin Administrativ MASHT 08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsimore dhe paragrafin 1.2 të nenit 3 të Udhëzimit Administrativ 24/2016 MASHT për sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimin Administrativ MASHT 22/2013 – Numri maksimal i nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës.

183. Nga të lartcekurat vërehet se nga parashtruesi i kërkesës kanë vijuar vendimet për riorganizimin e shkollave, për të cilat kishte organizuar inspektime Inspektorati i Arsimit duke përpiluar procesverbale lidhur me respektimin apo jo të vendimeve të parashtruesit të kërkesës nga ana e nxënësve në shkolla, si dhe vlerësimin e situatës në përgjithësi. Më pas, MASHTI dhe parashtruesi i kërkesës, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, përmes së cilit pajtohen që vendimi përkatës për riorganizim i parashtruesit të kërkesës të respektohet ndërsa një vendim tjetër shtyhet, dhe që dy palët në konsultim me komunitetin do angazhohen në rivlerësimin e propozimit për riorganizimin e arsimit në Komunën e Kamenicës. Gjithashtu, MAPL më 22 gusht 2020 kishte lëshuar një Opinion Ligjor, përmes së cilit, mes tjerash, kishte theksuar se në bazë të nenit 17, paragrafi 1 nënparagrafi (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë të drejtë në vendimmarrje sa i përket arsimit publik fillor dhe të mesëm dhe në kuadër të kësaj kompetence mund të riorganizojnë arsimin publik fillor dhe të mesëm. Mirëpo, në vijim pasojnë inspektime të reja nga ana e inspektoratit të arsimit, të cilat raportojnë mosvijueshmëri të disa nxënësve në shkolla. Rrjedhimisht, MASHTI formon komision *ad-hoc*, për vlerësimin e mosvijimit të mësimin nga ana e nxënësve dhe ky komision, përpilon raport përkatës ku rekomandon se MASHTI dhe parashtruesi i kërkesës duhet të ndërmarrin veprime të harmonizuara si dhe të themelojnë grupe punuese, për analizimin e situatës në shkolla.
184. Mirëpo, në rastin konkret, Gjykata vëren se përmes Vendimit të kontestuar, MASHTI, kishte nxjerrë Vendim përmes të cilit vet kishte organizuar “*mësimin alternativ të përshpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës*”. Vendimi i kontestuar në pikat e tij kishte përcaktuar që: (i) të kompensohen orët e humbura përmes organizimit të mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX), për nxënësit në 5 shkolla; (ii) themelohet komisioni në kuadër të MASHTI-it për hartimin e përmbajtjes mësimore për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit sipas pikës I të vendimit; (iii) mësimi alternativ i përshpejtuar për nxënësit sipas pikës 1 të këtij vendimi, zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës; (iv) orari mësimor të përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit sipas pikës 1 të vendimit, të mos pengohen nga orari i mësimin që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna; (v) të obligohet DKA në Kamenicë të sigurojë kushte optimale dhe furnizimin me materiale mësimore për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor për nxënësit sipas pikës I të vendimit; (vi) Inspektorati i Arsimit të obligohet që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike në fuqi dhe të këtij vendimi; dhe (vii) procesi mësimor zhvillohet në objektet shkollore më të afërta dhe në pajtim me rekomandimet e MASHTI-it, MSH-së dhe IKSHPK-së.
185. Më konkretisht, dhe për qëllim të rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se MASHTI përmes Vendimit të kontestuar përcakton se do kompensohen orët e humbura përmes “*organizimit të mësimin alternativ të përshpejtuar për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (1-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)*”, përkatësisht:

- “1.1. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Shipashnicë e Poshtme;
- 1.2. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Kopernicë;
- 1.3. Nxënësit e SHFMU "Hasan Prishtina" në Busavatë;
- 1.4. Nxënësit e SHFMU "Asllan Thaqi" në fshatin Karaçevë e Poshtme;
- 1.5. Nxënësit e SHFMU "Xhelal Sopi" në fshatin Petrocë.”

186. Më tej, Vendimi i kontestuar në pikën 3 përcakton se: *“Mësimi alternativ i përshpejtuar për nxënësit sipas pikës 1 të këtij vendimi, zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës”,* ndërsa në pikën 4 të tij përcakton se *“Orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit sipas pikës 1 të vendimit, të mos pengohen nga orari i mësimimit që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna.”*
187. Pika 7 e Vendimit të kontestuar thekson se: *“Procesi mësimor zhvillohet në objektet shkollore me të afërta dhe në pajtim me rekomandimet e MASHTI, MSH dhe IKSHPK-së.”*
188. Rrjedhimisht, në esencë, nga pikat e lartpërmendura, Gjykata vëren tri elemente që janë prekur nga Vendimi i kontestuar: (i) MASHTI ka organizuar mësim alternativ të përshpejtuar për Komunën e Kamenicës [parashtruesin e kërkesës], duke përcaktuar të organizohet ai mësim në pesë (5) shkolla përkatëse të Komunës së Kamenicës, shkolla këto që paraprakisht parashtruesi i kërkesës i kishte riorganizuar përmes vendimeve përkatëse si pjesë e reformës së tij; (ii) ka përcaktuar që mësimi alternativ i përshpejtuar për nxënësit sipas pikës (i), zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës dhe orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit të mos pengohen nga orari i mësimimit që janë duke zhvilluar në shkollat tjera; dhe (iii) ka përcaktuar që procesi mësimor zhvillohet në objektet shkollore më të afërta. Në këtë linjë, Gjykata do shqyrtojë çështjen e organizmit të mësimimit në shkollat përkatëse e cila ndërlihet me pikën 1 dhe 7 të Vendimit të kontestuar dhe çështjen e përcaktimit të mësimdhënësve për dhënien e mësimimit në ato shkolla, siç përcaktohet me pikën 3 dhe 4 të Vendimit të kontestuar. Çështja e efektit financiar të vendimit të kontestuar tashmë është trajtuar më lart (shih paragrafët 116-122, më lart)
189. Siç u tha më lart, MASHTI në pikën 7 të Vendimit të kontestuar kishte përcaktuar shprehimisht se mësimi do zhvillohet në objektet shkollore më të afërta me vendbanimin e nxënësve, përkatësisht organizimin e mësimimit për nxënësit e sh.f.m.u “Hasan Prishtina” në Busavatë, shkollë kjo e cila me vendimin për riorganizim të parashtruesit të kërkesës të 30 gushtit 2019, do duhej të kishin ndjekur mësimin në një shkollë tjetër, dhe organizmin e mësimimit për katër (4) shkolla ose paralele tjera që ishin riorganizuar me vendimin e parashtruesit të kërkesës të 10 janarit 2020.
190. MASHTI, poashtu kishte përcaktuar në pikën 3 dhe 4 të Vendimit të kontestuar se mësimi alternativ i përshpejtuar zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës dhe orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të

punojnë me nxënësit, të mos pengohen nga orari i mësimit që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna.

191. Në kontekst të lartcekurave, Gjykata duke aplikuar parimet e përgjithshme të Kushtetutës dhe të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, të shtjelluara në këtë Aktgjykim, do vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në raport me rrethanat e rastit konkret.
192. Në këtë aspekt, Gjykata duke pasur parasysh çështjen kryesore që është parashtruar para saj, përkatësisht, faktin se a ka cenuar MASHTI përgjegjësitë komunale me rastin e organizimit të mësimit alternativ të përshpejtuar, konsideron se në rastin konkret, kemi të bëjmë me çështjen e cila rregullohet me paragrafin 2 të nenit 12 të Kushtetutës, nën ky që thekson se kompetencat e njësisë të vetëqeverisjes lokale “*rregullohen me ligj*” në ndërlidhje paragrafin 1 dhe 3 të nenit 123 të Kushtetutës ku përcaktohet se e drejta në vetëqeverisje lokale “*garantohet dhe rregullohet me ligj*” dhe veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale “*bazohet në [...] Kushtetutë dhe në ligje*” dhe “*respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale*”. Duke vënë theks përsëri në “*ligj*”, Kushtetuta në paragrafin 2 të nenit 124 specifikon se “*kompetencat*” e komunave “*rregullohen me ligj*”, ndërsa paragrafi 3 i nenit 124 i liston tri lloje të kompetencave të cilat Komunitat mund t’i ushtrojnë, “*në pajtim me ligjin*”, dhe ato janë kompetencat a. vetanake, b. të zgjeruara dhe c. të deleguara.
193. Prandaj, Gjykata thekson se përkundër që parashtruesi i kërkesës ka pretenduar në përgjithësi shkelje të neneve 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, Gjykata për qëllime të këtij rasti, dhe bazuar në rrethanat konkrete e dispozitat e lartpërmendura, vëren se gjen zbatim paragrafi 2 i nenit 12 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 123 Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 124 të Kushtetutës.
194. Në këtë aspekt, dhe duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 123 të Kushtetutës, përkatësisht referimin në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, dhe duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në paragrafin 4 të nenit 4 të saj, thekson se kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë “*të plota dhe ekskluzive*” si dhe ato kompetenca nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal “*përveç siç përcaktohet me ligj*”. Poashtu, paragrafi 1 i nenit 8 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, thekson se çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm “*sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji.*”
195. Gjykata gjithashtu rikujton se Komisioni i Venecias, në Opinionin CDL-AD (2015) 028 lidhur me Amendamentet në Kushtetutën e Ukrainës, kishte përcaktuar që (i) një tipar thelbësor i rregullimit të vetëqeverisjes lokale është identifikimi i funksioneve bazë (funksioneve “vetanake” për dallim nga kompetencat e deleguara) dhe një zgjidhje do të konsistonte në përcaktimin në nivel kushtetues të “kompetencave vetanake” të njësisë të vetëqeverisjes lokale e cila do parandalonte qeveritë që të heqin kompetencat nga qeverisja lokale, në ata nuk disponojnë

shumicën e kualifikuar; dhe (ii) një përmirësim tjetër sipas Komisionit të Venecias është që Kushtetuta të përcaktojë që *“parimet themelore të kompetencave të vetëqeverisjes lokale përcaktohen me ligj organik”*.

196. Gjykata për më tepër rikujton se, autonomia komunale shprehet para së gjithash në kuptim të disponimit dhe realizimit të kompetencave vetanake nga ana e komunave *“siç përcaktohet me ligj”*. Këto kompetenca, që në kuptim të paragrafit 4 të nenit 113 cilësohen si *“përgjegjësi komunale”*, janë të përcaktuara në ligje përkatëse që organi legjislativ, kur ushtron diskrecion në përcaktimin e fushave të këtyre kompetencave, është i lidhur me detyrimin që kompetencat që parashikohen në ligje përkatëse, të jenë së paku ato që janë rrjedhojë e parimeve të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 124 të Kushtetutës, përkatësisht kompetenca a. vetanake, b. të zgjeruara dhe c. të deleguara, parime këto që i përcakton edhe Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke theksuar që kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive. Bazuar në parimet kushtetuese dhe atyre që burojnë nga Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, këto kompetenca nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal *“përveç siç përcaktohet me ligj”* dhe çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm *“sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji”*.
197. Siç është sqaruar edhe më lart, tek parimet e përgjithshme, Kushtetuta përcakton kornizat lidhur me parimet e organizimit dhe funksionimit e vetëqeverisjes lokale, duke i garantuar ndër të tjera, kompetenca të quajtura *“vetanake”*.
198. Në zbatimin e këtij vlerësimi, Gjykata duhet që të përcaktoj nëse Vendimi i kontestuar ka cenuar përgjegjësitë komunale në atë që u garantohet si përcaktim kushtetues mbi kompetencat vetanake të komunave, llojet e të cilave janë të numëruara në ligje përkatëse. Pra, Gjykata do vlerësojë nga leximi i dispozitave të lartcekura të Kushtetutës dhe të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, a është cenuar përgjegjësia komunale, përkatësisht kompetenca e parashtruesit të kërkesës nga MASHTI, përmes Vendimit të kontestuar, përkatësisht a ka ndërhyrë në rastin konkret, autoriteti qendror tek autoriteti lokal, në kompetencën vetanake të komunës, në mënyrën e cila nuk është e përcaktuar me ligj. Kjo sepse në fakt, ligji ka zbatuar normën kushtetuese, dhe si i tillë do shfrytëzohet nga Gjykata për përcaktimin e karakterit zbatues të tij.
199. Siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës nuk i konteston kompetencat e MASHTI-it lidhur me nenin 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, mirëpo thekson se këto kompetenca nuk përcaktojnë *“organizimin”* e mësimin alternativ apo shtesë nga ana e MASHTI-it.
200. Në këtë linjë, Gjykata më lart ka analizuar bazën ligjore, duke vërejtur se në rastin konkret, baza kryesore ligjore konsiston në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjit për Arsimin në Komunat. Në këtë kontekst, në kuptim të Vendimit të kontestuar, kompetenca e komunave e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale përcakton (i) *ofrimin e arsimit publik parashkollor,*

fillor dhe të mesëm; duke përfshirë (ii) regjistrimin dhe licencimi e institucioneve edukative; dhe (iii) punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit, si kompetencë që hyn në kategorinë e kompetencave themelore në të cilat udhëzon detyrueshëm paragrafi 3 i nenit 124 të Kushtetutës dhe e cila përbën një element thelbësor të asaj që neni 12 i Kushtetutës e quan e drejtë e “vetëqeverisjes lokale”.

201. Gjithashtu, Komunat siç përcaktohet me Ligjin për Arsimin në Komunat, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 4 të tij përcakton *“kompetenca të plota dhe ekskluzive”* në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë (i) *regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore; dhe (ii) marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimeve dhe administratorëve, ndërsa siç përcaktohet nga neni 5 i Ligjit për Arsimin në Komunat, i njëjti, ka përcaktuar më tej kompetencat e komunave duke përcaktuar që përpos kompetencave të parashikuara në nenin 4 të Ligjit mbi Arsimin në Komunat, përfshihen edhe “kompetencat e veçanta komunale”, e që për qëllime të rrethanave të rastit konkret, janë të tilla, por duke mos u kufizuar (i) në ndërtimin e objekteve shkollore; (ii) punësimin e mësimeve dhe personelit tjetër të shkollave; (iii) regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë (iv) pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin.*
202. Në anën tjetër, Gjykata vëren se kompetencat e MASHTI-it sipas paragrafit 1 dhe 8, 9 dhe 10 të nenit 5 për Ligjin për Arsimin Parauniversitar, mes tjerash, konsistojnë në kompetenca të natyrës së planifikimit, caktimit të standardeve dhe sigurimit të cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, mes tjerash, duke zhvilluar politika dhe hartim legjislacioni, vendosje të kriterëve për licencim të mësimeve, dhe mes tjerash, të (i) miratojë standarde përkatëse; dhe (ii) licencojë dhe akreditojë institucione.
203. Më konkretisht, lidhur me mësimin alternativ, i cili është edhe qëllimi i Vendimit të kontestuar, nënparagrafi 6.3 i nenit 8 (Inspektimi i Arsimit) të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, thekson se në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit, *“Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimin shtesë ose alternativ.”*
204. MASHTI mbështetet në argumentin që Vendimi i kontestuar bazohet në kompetencat e saj sipas Rregullores së Qeverisë 02/2021, neni 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, shtojca I. Megjithatë, Gjykata vëren se kjo dispozitë e Rregullores së Qeverisë përcakton që Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri, nxjerr vendime dhe akte nënligjore si dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë. Në këtë linjë, MASHTI në esencë konsideron se ka nxjerrë vendim [Vendimin e kontestuar], në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë, përkatësisht fushën e arsimit.

205. Marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata, së pari, vëren se me rastin e organizimit të mësimit alternativ të përshpejtuar, dhe përcaktimit të organizimit të mësimit në objektet përkatëse shkollore në Komunën e Kamenicës, objekte këto të riorganizuara nga ky i fundit, përmes Vendimit të kontestuar, MASHTI, ka tejkaluar kompetencën e përcaktuar në nënparagrafin 6.3 të paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, sepse MASHTI në rastin konkret, në rolin e tij si inspektues i arsimit, siç përcaktohet me nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar ka kompetencën “që të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit”, dhe jo të bëjë “organizimin” e mësimit shtesë ose alternativ. Për më tepër MASHTI, nuk ka kompetencë të “organizojë” objektet shkollore se ku do vijojnë mësimin nxënësit përkatës.
206. Gjykata fillimisht thekson se edhe pse shprehimisht nuk përcaktohet kompetenca e komunave për riorganizim të arsimit publik fillor dhe të mesëm, vetë kompetenca vetanake për “*ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm,*” nënkupton që hyn edhe kompetenca për organizimin e mësimit shtesë ose alternativ, sipas rekomandimeve të MASHTI-it.
207. Së dyti, sa i përket përcaktimit të mësimdhënësve, përmes Vendimit të kontestuar, ku përcaktohet se orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit, të mos pengohen nga orari i mësimit që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna, Gjykata rikujton se sipas argumentit të parashtruesit të kërkesës, MASHTI ka angazhuar mësimdhënës të cilët nuk janë të punësuar pranë parashtruesit të kërkesës, e që sipas parashtruesit kjo vërtetohet me raportin sipas provës nr. 12 të kërkesës. Kundërargumentet e MASHTI në anën tjetër konsistojnë në pohimet se (i) asnjë nga mësimdhënësit nuk ka kërkuar kompensim shtesë në angazhimin e tyre; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë asnjë dëshmi që janë krijuar shpenzime shtesë edhe pasi vendimi është ekzekutuar.
208. Gjykata konsideron se i takon Komunës së Kamenicës [parashtruesit të kërkesës], të përcaktojë lidhur me mësimdhënësit sepse sipas Ligjit për Arsimin në Komunitet i njëjti ka kompetencë punësimitin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave. Rrjedhimisht, kjo kompetencë, bazuar në ligjin e aplikueshëm, është kompetencë vetanake e komunës.
209. Gjykata rikujton që fakti që e drejta në vetëqeverisje lokale, dhe mbrojtja kushtetuese e saj, përcaktohet në pjesën e dispozitave themelore të Kushtetutës përkatësisht në nenin 12 të saj, është tregues i rëndësisë, statusit dhe karakterit fundamental që e drejta e vetëqeverisjes lokale ka në sistemin demokratik e kushtetues të Republikës së Kosovës. Për më tepër, Gjykata rikujton që e drejta e vetëqeverisjes lokale përbën një nga dy kanalet kryesore të legjitimitetit popullor përmes pjesëmarrjes në zgjedhje të drejtpërdrejta, rrjedhimisht autonomia e komunave duhet mbrojtur në kuptim të një parimi fundamental kushtetues.

210. Prandaj, marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata konstaton që Vendimi i kontestuar i MASHTI-it përmes organizimit të mësimit alternativ të përshpejtuar për nxënësit e Komunës së Kamenicës përbën cenim të përgjegjësive të Komunës së Kamenicës për *“ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm”*, që, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 12 të Kushtetutës, paragrafit 1 dhe 3 të nenit 123 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 124 të Kushtetutës, përbën kompetencë e paraparë me ligj, ndërsa sipas paragrafit 3 të nenit 124 të Kushtetutës, përbën kompetencë e paraparë me ligj si *“kompetencë vetanake”*. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që Vendimi i kontestuar cenon përgjegjësitë e Komunës së Kamenicës [parashtruesit të kërkesës] të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kërkesa për masë të përkohshme

211. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme, duke e kërkuar atë për shkak të ndërhyrjes në kompetencat e tij dhe për shkak të ndikimit tek nxënësit. I njëjti kishte theksuar se ka ofruar prova të mjaftueshme që do shkaktohet dëm i riparueshëm dhe caktimi i masës së përkohshme është me interes publik, sepse nxënësve të përfshirë në këtë rast, do të iu ofrohej mundësi të arsimohen në shkollat e licencuara që ata të pajisen me dokumente përkatëse për vitin shkollor 2020/2021.
212. Gjykata më sipër ka konstatuar se Vendimi i kontestuar nuk është në përputhje me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
213. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.4 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 40 të Ligjit, dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) të Rregullores së punës, më 10 mars 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, që Vendimi nr.01B/24 i 23 prillit 2021 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafin 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funkionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË REFUZOJË, kërkesën për masë të përkohshme;
- IV. TË REFUZOJË, kërkesën për tërheqje të kërkesës;
- V. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesit të kërkesës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani